



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 162 Akti

Nr. 159 Vendimi

Tiranë, më 14.6.2019

V E N D I M

Trupi gjykues nr. 4 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj	Kryesues
Genta Tafa (Bungo)	Anëtare
Valbona Sanxhaktari	Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Fiorela Mandro, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Hans Kijlstra, në datën 12.6.2019, ora 14:00, zhvilloi në Pallatin e Kongreseve, seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Idriz Mulkurti**, gjyqtar në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda, i cili nuk ishte i pranishëm në seancën dëgjimore, por u përfaqësua nga avokat Sokol Azizaj, me nr. license ***.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** dhe nenet “A”, “Ç”, “D”, “DH”, “E” dhe “Ë” të Aneksit të Kushtetutës;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Valbona Sanxhaktari, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Idriz Mulkurti është subjekt i rivlerësimit për shkak të pozicionit të tij si gjyqtar, në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda. Bazuar në nenin 4, pika 4, dhe në nenin 14, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, si dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim, “Komisioni”) ka hedhur shortin në datën 15.5.2018, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr.4.
2. Me vendimin e trupit gjykues, datë 24.5.2018, është vendosur kryesues z. Lulzim Hamitaj dhe është deklaruar lidhur me konfliktin e interesit nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues.
3. Më tej, subjekti i rivlerësimit është njoftuar për përbërjen e trupit gjykues, i cila ka deklaruar se nuk ka konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.
4. Janë administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor. Subjekti është kontaktuar nëpërmjet adresës elektronike, të deklaruar për hetim të mëtejshëm, ku iu dërgua pyetësi i përgatitur nga Komisioni si dhe pyetje të tjera.
5. Në datën 16.5.2019, trupi gjykues vendosi: (i) të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Idriz Mulkurti, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit: kriterin e vlerësimit të pasurisë, kriterin e kontrollit të figurës dhe atë të vlerësimit profesional; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit dhe barrën e provës, ta ftojë atë për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si edhe afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta dhe të paraqesë parashtrimet e saj.
6. Subjekti i rivlerësimit u njoh me dosjen dhe mori një kopje të saj, fakt të cilin edhe e konfirmoi. Subjekti paraqiti brenda afatit të përcaktuar shpjegime dhe prova lidhur me barrën e provës dhe rezultatet e hetimit të Komisionit.
7. Trupi gjykues u shpreh në datën 10.6.2019 lidhur me kërkesat e subjektit për marrjen e provave dhe thirrjen e dëshmitarëve dhe njoftoi subjektin për këtë vendim.
8. Trupi gjykues ftoi subjektin e rivlerësimit, z. Idriz Mulkurti, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, në seancë dëgjimore, në datën 12.6.2019, ora 14:00, në Pallatin e Kongreseve, Tiranë.

SEANCA DËGJIMORE

9. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 12.6.2019, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Hans Kijlstra.
10. Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit nuk u paraqit vetë, por kishte zgjedhur një përfaqësues, z. Sokol Azizaj, përfaqësuar me prokurë të posaçme nr. *** rep., nr. *** kol., me NIPT ***, dhe me nr. license ***. Përfaqësuesi paraqiti shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit, si dhe iu përgjigj pyetjeve të drejtuara nga anëtarët e trupit gjykues. Në përfundim të seancës dëgjimore, përfaqësuesi i subjektit të rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë për subjektin e rivlerësimit, z. Idriz Mulkurti.
11. Trupi gjykues përfundoi seancën dëgjimore dhe për rrjedhojë edhe procesin e rivlerësimit për z. Idriz Mulkurti në seancën e datës 14.6.2019, në të cilën as subjekti, dhe as përfaqësuesi i tij nuk ishin të pranishëm.

PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

12. Procesi i rivlerësimit, i cili kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Anëtarët e Komisionit *hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit*. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indice në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

13. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja dhe provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë këtij institucioni në “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, ‘Vetting’”;
- b) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga DSIK-ja, së bashku me dokumentacionin shoqërues;
- c) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, së bashku me materialin shoqërues;
- ç) Dokumente shkresore të vëna në dispozicion nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- d) Deklarimet të vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet komunikimit elektronik;
- dh) Shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, si dhe provat e paraqitura në përfundim të hetimit kryesisht;
- e) Denoncimet nga publiku.

A. VLERËSIMI I PASURISË

14. Subjekti i deklaramit ka dorëzuar deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit pranë ILDKPKI-së, së bashku me dokumentacionin provues. Kjo deklaratë, në bazë të nenit 33¹ të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, iu nënshtrua hetimit administrativ nga ILDKPKI-ja.

15. Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në nenin 33, pika 5, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja në raportin e saj ka konkluduar se:

- a) *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- b) *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- c) *ka kryer fshehje të pasurisë;*
- d) *ka kryer deklaram të rremë;*
- e) *subjekti i rivlerësimit nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

16. Megjithëse, sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017 dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.²

¹“*Procedura e vlerësimit të pasurisë 1. ILDKPKI-ja, bazuar në deklaramet e pasurive, zhvillon një procedurë të plotë kontrolli në përputhje me ligjin. “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”, ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” si dhe “Kodin e Procedurave Administrative”.*

² Vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese, “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të

17. Deklarata e pasurisë e subjektit të rivlerësimit, z. Idriz Mulkurti iu nënshtrua një hetimi administrativ të thelluar, i cili konsistonte në verifikimin e vërtetësisë dhe saktësisë së deklaramëve të bëra nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit, të ardhurat, shpenzimet, nëse ka konflikt interesi, fshehje të pasurisë apo deklarim të rremë, si dhe përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen.

18. Në përfundim të hetimit administrativ, kur Komisioni krijoi bindjen se provat kanë nivelin e provueshmërisë, vendosi t'i japë të drejtë subjektit të njihet me të gjithë dokumentacionin e administruar në dosje dhe rezultatet e hetimit, si dhe i kaloi atij barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit si më poshtë vijon:

19. **Apartament banimi** me sipërfaqe 84 m², me adresë: Rr. "****", Njësia nr. ****, Tiranë, porositur sipas kontratës së sipërmarrjes me nr. **** rep., nr. **** kol., datë 6.9.2006, në vlerën 50.600 euro (6.259.372 lekë³), dhe blerë me kontratën e shitblerjes nr. **** rep., nr. **** kol., datë 26.6.2010.

20. *Burimi i krijimit sipas deklaratës "Vetting"*: Të ardhura nga kursimet *cash* në shumën prej 1.000.000 lekësh, si dhe 5.000.000 lekë kredi marrë në "Raiffeisen Bank".

21. Konstatimi i ILDKPKI-së: *Deklarim i rremë dhe mungesë burimi të ligjshëm financiar për blerjen e apartamentit me sip. 84 m², rruga "****" Tiranë, blerë në vitin 2006, pasi kredia, e cila ka shërbyer si burim, është disbursuar pas datës së lidhjes së kontratës së sipërmarrjes.*

22. Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se pagesat për apartamentin janë kryer brenda vitit 2006, përkatësisht: (1) kësti i parë në datën 6.9.2006, në shumën 20.600 euro (2.548.282 lekë); dhe (2) kësti i dytë në datën 4.12.2006, në shumën 30.000 euro (3.700.000 lekë), fakt ky i provuar edhe nga mandatpagesat.

23. Komisioni përgatiti analizën financiare për të vlerësuar aftësitë paguese të subjektit për të kryer pagesën e këstit të parë prej 20.600 eurosh (ose 2.548.282 lekë).

Përshkrimi	Viti 2005	Viti 2006 deri më 6.9.2006
TË ARDHURA	1 210 248	845 048
Të ardhura nga paga e subjektit, të dokumentuara	1 127 943	729 523
Të ardhura nga paga e bashkëshortes së subjektit, të dokumentuara	82 305	115.525
SHPENZIME	547 785	365 190
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	547 785	365 190
Kursime <i>cash</i> të deklaruara nga subjekti në DPV	500 000	
Aftësia REALE për të kursyer deri në fund të vitit	500 000	479 858

23.1 Nga analiza e kryer rezultoi se në vitin 2005 subjekti ka pasur mundësi për të kursyer shumën e deklaruar prej 500.000 lekësh. Për periudhën 1.1.2006 deri më 6.9.2006, kur është kryer pagesa e këstit të parë, subjekti ka mundur të kursejë shumën prej 479.858 lekësh.

23.2 Deri në datën e pagesës së këstit të parë subjekti ka pasur realisht mundësi të kursejë shumën prej 979.858 lekësh.

24. Për shlyerjen e këstit të dytë të çmimit të apartamentit është përdorur një kredi në shumën 5.000.000 lekë, e cila është marrë në "Raiffeisen Bank" me kushte lehtësuese, është disbursuar në datën 4.12.2006 dhe tërhequr e plotë në të njëjtën ditë nga subjekti i rivlerësimit. Në të njëjtën datë është shlyer edhe kësti i dytë i çmimit të blerjes së pasurisë në vlerën 3.700.000 lekë. Kjo pagesë është kryer *cash* në arkën e shoqërisë "****" sh.p.k.

25. Nga hetimi rezultoi se:

rivlerësimit". Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit gjatë këtij procesi."

³ Sipas kursit zyrtar mesatar të BSH-së, 123.7 lekë

- subjekti ka pasur mungesë burimesh të ligjshme, *në vlerën prej 1.568.424 lekësh*, për pagesën e këstit të parë prej 20.600 eurosh (konvertuar në 2.548.282 lekë) në datën 6.9.2006;
- nuk përputhen deklaratimet e subjektit në deklaratën “Vetting”, si dhe deklarinimin periodik vjetor me dokumentacionin e administruar në dosje, lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie.

26. Bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit për këtë pasuri.

27. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se deklarimi i pasurisë është bërë vjetor, ku aftësia paguese për këtë aset përputhet me të ardhurat në atë periudhë. Lidhur me pagesën me këste, subjekti shpjegoi se e ka shlyer firmën në datën 6.9.2006 në shumën 20.600 euro, konvertuar në 2.548.282 lekë, por në kushtet kur në atë periudhë nuk ka pasur mundësi reale për të paguar këstin e parë, pasi kredia nuk ishte lëvruar, deklaroi se ka marrë hua shumën prej 1.500.000 lekë *cash*, pa interes, tek z. R. G., në gusht të vitit 2006, deri në lëvrimin e kredisë, hua të cilin e ka kthyer në dhjetor të vitit 2006, kohë kur ka tërhequr kredinë.

28. Këtë deklarinim subjekti e bën për herë të parë duke shpjeguar se nuk e ka pasqyruar këtë fakt në deklarinimet e tij sepse nuk e ka pasur detyrim, pasi deklarimi ka qenë vjetor. Për të provuar këtë fakt, subjekti ka paraqitur një deklarinatë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.5.2019, mes tij dhe shtetasit R. G. Lidhur me këtë fakt ai kërkoi të thirret dhe të pyetet me cilësinë e dëshmitarit z. R. G.

29. Trupi gjykues vendosi të pranojë deklarinatën noteriale dhe refuzoi thirrjen e shetasit R. G., me cilësinë e dëshmitarit, për sa kohë ai ka lëshuar deklarinatën para noterit ku ka shprehur vullnetin e tij lidhur me objektin që kërkohet dëshmia.

30. Në vlerësim të shpjegimeve të subjektit, si dhe provave të paraqitura, trupi gjykues vlerëson se subjekti ka bërë për herë të parë deklarinim të ndryshëm lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave për pagesën e këstit të parë të apartamentit nëpërmjet huas, të cilin nuk e ka deklaruar as gjatë pyetësorëve të dërguar. Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion provues për të bërë të besueshëm për Komisionin transferimin e këtyre shumave nëpërmjet bankës apo duke dokumentuar marrjen e këtyre parave në atë periudhë. Deklarata që subjekti ka sjellë në cilësinë e provës përfaqëson një akt të njëanshëm deklarativ, i cili nuk provon dhënien e huas subjektit dhe kthimin e saj tek huadhënësi, apo burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësit, sipas kërkesave të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

31. Shpjegimet e subjektit nuk bindën trupin gjykues lidhur me aftësinë paguese të tij për pagesën e këstit të parë në shumën 20.600 euro, për blerjen e apartamentit dhe nuk provuan të kundërtën e rezultateve të hetimit.

32. Garazh me sipërfaqe 22.2 m², me adresë: Rr. “***”, Njësia nr. ***, blerë⁴ në datën 26.6.2010, në vlerën 14.000 euro, konvertuar në lekë⁵ në vlerën 1.943.340 lekë.

33. *Burimi i krijimit sipas deklarinatës “Vetting”*: Të ardhura nga kursimet *cash*, si dhe të ardhura në shumën 10.800 euro (konvertuar⁶ në 1.499.148 lekë) nga qiradhënia e apartamentit në ***.

34. Konstatimi i ILDKPKI-së: *Deklarim i rremë dhe mungesë burimi të ligjshëm financiar për blerjen e garazhit me sip. 22.2 m², në Rr. “***”, Tiranë, në vitin 2010, pasi garazhi është blerë në datën 26.6.2010, kurse kontrata e qirasë mban datën 30.9.2010.*

*Është e dyshimtë vlera e qiradhënies 300 euro/muaj për apartamentin me sip. 59m², në ***, pretendimi se është parapaguar vlera totale 10.800 euro (për 3 vjet), si dhe mënyra e marrjes së kësaj vlere në rrugë jo bankare.*

⁴ Fituar me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.6.2010.

⁵ Sipas kursit mesatar të BSH-së në vitin 2010

⁶ Sipas kursit mesatar të BSH në vitin 2010

35. Mbështetur në deklaratimet e subjektit për të blerë këtë pasuri në vlerën e deklaruar prej 14.000 eurosh (1.943.340 lekë), subjektit i nevojiteshin, përveç të ardhurave nga qiraja në shumën prej 10.800 eurosh (ose 1.499.148 lekë) dhe 3.200 euro (ose 444.192 lekë), të ardhura nga kursimet.

36. Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar kursime në vitet 2007 – 2008 – 2009, përkatësisht nga 500.000 lekë (1.500.000 lekë). Analiza financiare lidhur me kursimet e vitit 2007 dhe 2008, paraqitet më poshtë tek pasuria automjet tip “Benz-200”, duke konsideruar se ato kanë shërbyer për blerjen e automjetit tip “**Benz-200**”, në datën 18.1.2010.

Analiza financiare mbi mundësitë e kursimit në vitin 2009

Përshkrimi	Viti 2009
PASURI	415 496
Ndryshimi i likuiditetit (gjendje në fillim të vitit - gjendje në fund të vitit)	415 496
DETYRIME	-309 829
Shlyerje e kredisë për strehim, për blerjen e apartamentit në Tiranë, nga “Raiffeisen Bank”	-309 829
TË ARDHURA	1 514 398
Të ardhura nga paga e subjekti, të dokumentuara	1 168 872
Të ardhura nga bashkëshortja, të dokumentuara	345 526
SHPENZIME	829 705
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	683 100
Shpenzime interesi për shlyerjen e kredisë tek “Raiffeisen Bank”	127 988
Shpenzim për pasaportën (sipas vërtetimeve të pagave, viti 2009)	4 900
Shpenzime udhëtimi jashtë vendit - TIMS	13 717
REZULTATI FINANCIAR = Të ardhura - (Pasuri -Detyrime) - Shpenzime	-40 632
Kursime <i>cash</i> të deklaruara nga subjekti në DPV	500 000
Aftësia REALE për të kursyer deri në fund të vitit	459 368

37. Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka pasur *mundësi* të paguajë *shumën* prej 3.200 eurosh, ose 444.192 lekë, në periudhën mars – qershor të vitit 2010 me të ardhura nga kursimet.

38. Në pyetësin e datës 2.5.2019, subjekti ka deklaruar se kursimet *cash* deri në fund të vitit 2011 i ka përdorur për arredimin e shtëpisë dhe pagesën e mbetur prej 3.200 eurosh ndaj firmës “***” sh.p.k., i ka përdorur për garazhin.

39. Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se sipas mandatpagesave në arkën e shoqërisë, pagesat për garazhin janë kryer në vitin 2010: përkatësisht **8.000 euro** në datën 1.3.2010 dhe **6.000 euro** në datën 1.5.2010. Edhe në deklaratimet periodike dhe deklarin “Vetting” subjekti ka deklaruar se ka kryer këtë pagesë në vitin 2010 me të ardhura nga kursimet në vitet 2008 - 2009 dhe të ardhurat nga qiraja në shumën prej 10.800 eurosh.

40. Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka pasur mundësi financiare për kryerjen e pagesës për pjesën e mbetur në vlerën prej 3.200 eurosh dhe se pagesat kanë qenë përkatësisht 8.000 dhe 6.000 euro.

41. Duket se ka një mospërputhje mes deklaratimeve të subjektit në DPV dhe deklaratën “Vetting” me deklaratimet e tij në pyetësin e datës 2.5.2019, si dhe deklaratimet e bëra pranë ILDKPKI-së në vitin 2012, të cilat, në fakt, lidhen me gjendjen *cash* në shtëpinë e subjektit në vitin 2011.

42. Subjekti ka deklaruar si burim për blerjen e garazhit, të ardhurat në shumën 10.800 euro (konvertuar në 1.499.148 lekë), nga një kontratë qiraje nr. *** rep., datë 30.9.2010 të lidhur me shtetasin K. H. K., për dhënie me qira për banesë të apartamentit në *** (i trajtuar më poshtë), me afat 3-vjeçar, me çmim 300 euro/muaj, i parapaguar dhe me efekt prapaveprues.

43. Nga hetimi rezultoi se në vitin 2010 nuk ka pasur çmim reference për qiratë e banesave, por nëse i referohemi Vendimit nr. 469, datë **3.6.2015** të Këshillit të Ministrave “Mbi

përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore”, për zonën e Tropojës, vlera minimale e qirasë mujore për çdo metër katror është: $27.190 \text{ lekë}^7 \times 0.3\% = 81.57 \text{ lekë}/\text{m}^2$, vlera minimale e qirasë mujore për apartamentin e dhënë me qira nga subjekti është: $84.57 \text{ lekë}/\text{m}^2 \times 59 \text{ m}^2 = 4.813 \text{ lekë}$ (ose përafërsisht 35 euro në muaj).

44. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar lidhur me çmimin e qirasë si dhe aftësitë paguese të qiramarrësit se:

1) Në momentin që kemi bërë marrëveshjen, qiramarrësi është paraqitur si menaxher i shoqërisë “***” sh.p.k. dhe ka marrë banesën me qira me efekt prapaveprues, pasi sipas tij kishte pikësynim të ushtronte aktivitetet biznesi në atë zonë, eksport import të mallrave të ndryshëm, në fushën e bimëve medicinale, shërbim turistik malor dhe atë minerar. Po kështu, kemi rënë dakord që pagesa do kryhej në paradhënie, në këste, dhe për këtë shkak unë kam marrë nga qiramarrësi vlerën tërësore prej 10.800 eurosh, cash paradhënie, vlerë e cila me sa mbaj mend, më është dorëzuar pjesë-pjesë, të cilat në atë moment më nevojiteshin për të blerë garazh për mjetin, meqenëse për shkak të detyrës, në disa raste, isha bërë objekt sulmi.

2) Për caktimin e vlerës së qirasë jemi referuar në nenin 22 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, që përcakton amortizimin, pasi apartamentin e kam pasur të restauruar, dhe në momentin e marrëveshjes e kemi vlerësuar vlerën e mbetur me rreth 20.000 euro, ndërsa pajisjet me vlerën rreth 5.000 euro, sepse ato kanë qenë në gjendje të mirë. Meqenëse apartamenti është dhënë në funksion për ushtrimin aktivitetet biznesi, kuptohet që dëmtimi i tij do të ishte më i madh se i një banese të zakonshme. Në këto kushte është llogaritur amortizimi për tre vite të banesës rreth 15 % e vlerës 20.000 euro të banesës, ai i pajisjeve rreth 60 % e vlerës 5.000 euro të pajisjeve, po kështu, paga për tatimin mbi qiranë prej 10% e vlerës 10.800 euro të qirasë, e cila do të paguhej nga qiradhënësi, si dhe rreth 15% e vlerës 10.800 euro të qirasë është llogaritur pagesa për shërbimet e të tretëve (drita, ujë, internet) që do të përballoheshin nga qiradhënësi, sipas marrëveshjes, e cila është formalizuar në kontratë qiraje para noterit, më datë 30.9.2010.

3) Qiramarrësi ka pasur mundësi financiare për shlyerjen e shumës paradhënie për vetë faktin sepse ai ka qenë administrator e pastaj menaxher i shoqërisë “***” sh.p.k dhe banesën do ta merrte në funksion të kësaj shoqërie, ku sipas bilancit datë 31.12.2009, që më është vënë në dispozicion në momentin e marrëveshjes, ka pasur depozitë në bankë dhe llogari të tjera të mjaftueshme për të përballuar paradhënien, ndërkohë unë shfrytëzoja këtë okazion, pasi kisha nevojë dhe banesën e kisha të lirë.

4) Arsyeja e marrjes së këtij ambienti me qira sipas qiramarrësit ka qenë të ushtronte aktivitetet biznesi në atë zonë, eksport-import të mallrave të ndryshëm, në fushën e bimëve medicinale, hoteleri, shërbim turistik, malor dhe atë minerar.

❖ Analiza e provave

45. Lidhur me përcaktimin e çmimit të qirasë me bazë amortizimin sipas nenit 22 të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, sipas deklaratimit të subjektit të rivlerësimit, pas vlerësimit të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi, rezulton se amortizimi⁸ ka qëllim të rregullojë vetëm aktivitetet e veprimtarisë të një subjekti tatimor për efekt të përcaktimit të fitimit të tatueshëm nga aktiviteti tregtar dhe nuk mund të merret bazë për përcaktimin e çmimit të qirasë së një pasurie të individit.

46. Lidhur me çmimin e qirasë referuar faktit se apartamenti ka qenë i restauruar dhe me pajisje të mira, ky fakt mbetet i aprovuar pasi subjekti nuk ka deklaruar shpenzime për restaurim apo

⁷ VKM-ja nr. 469, datë 3.6.2015; çmimi i referencës për metër katror në qytetin e ***, sipas tabelës nr. 2.

⁸ Shih nenin 22 të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”.

blerje pajisjesh për apartamentin në asnjë nga deklaratat periodike, dhe për pasojë nuk janë llogaritur në analizën financiare.

47. Lidhur me pagesat për furnizimin me energji elektrike, sipas informacionit të marrë nga OSHEE⁹, vërehet se gjatë afatit të kontratës së qirasë, subjekti nuk ka kryer asnjë pagesë për energjinë elektrike deri në janar të vitit 2015. Në vitin 2015 subjekti ka paguar të gjithë detyrimet e prapambetura. Nga faturimet përkatëse të periudhës 2010 – 2013 rezulton se ato kanë qenë të ulëta, kryesisht tarifë fikse shërbimi.

48. Sipas informacionit të marrë nga Ujësjiellës Kanalizime Tropojë¹⁰ për furnizimin me ujë, nuk rezultoi se subjekti të jetë furnizuar me ujë dhe të ketë pasur kontratë me UK-në Tropojë.

49. Nga hetimi **nuk rezultoi** se z. K. K., të ketë vepruar në lidhjen e kësaj kontrate në cilësinë e menaxherit të shoqërisë “****” sh.p.k., pasi ai duhet të ishte autorizuar¹¹ nga shoqëria për të vepruar në emër dhe për llogari të saj. Po ashtu, kontrata rezulton e lidhur me të si individ/shtetas dhe jo me shoqërinë “****” sh.p.k., përfaqësuar nga shtetasi K. K., me cilësinë e menaxherit.

50. Gjithashtu, nga administrimi i të dhënave të publikuara në Regjistrin Tregtar të QKB-së, rezulton se shtetasi K. K., nuk ka qenë administrator i kësaj shoqërie në datën e lidhjes së kontratës¹².

51. Nga të dhënat e regjistruara në QKB nuk rezultoi se shoqëria “****” sh.p.k. të kishte të regjistruar si adresë të ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë, adresën e apartamentit në ***, apo të ishte pajisur me NIPT sekondar. Ky subjekt kishte të regjistruar në QKB, si vend ekskluziv për ushtrimin e aktivitetit, vetëm adresën në Tiranë, në “****”.

52. Në lidhje me tatimin në burim, legjislacioni tatimor parashikon¹³ se në rastet kur qiramarrësi është person juridik, ai ka detyrimin të mbajë tatimin në burim (në momentin e pagesës ndaj qiradhënësit) dhe ta paguajë në organin tatimor përkatës, jo më vonë se data 20 e muajit që pason muajin në të cilin është kryer pagesa. Nga dokumentacioni rezultoi se pagesa e tatimit mbi të ardhurat ishte bërë nga z. Mulkurti.

53. Pagesa e tatimit në burim rezultoi se është kryer nga vetë subjekti i rivlerësimit në datën 28.9.2012, dy vite më vonë, dhe nuk rezultoi të ishte paguar ndonjë gjorbë për shlyerjen e tij me vonesë, sipas parashikimeve në legjislacionin tatimor.

54. Lidhur me aftësitë paguese të shtetasit K. K., subjekti ka deklaruar se si burim kanë shërbyer të ardhurat e shoqërisë “****” sh.p.k., duke e bazuar pretendimin në një dokument, kopje të bilancit të datës 31.12.2009 të shoqërisë. Nëse pagesa e qirasë do të ishte kryer nga shoqëria “****” sh.p.k. si person juridik, ajo duhet të ishte bërë sipas legjislacionit tatimor¹⁴ nëpërmjet sistemit bankar, dhe jo me para në dorë (*cash*), sikurse është deklaruar nga subjekti dhe se shoqëria duhet ta kishte deklaruar pagesën si shpenzim për vitin 2010, fakt ky që nuk rezultoi nga hetimi.

55. Lidhur me deklaratimet e subjektit para Komisionit se qiramarrësi është paraqitur si menaxher i shoqërisë “****” sh.p.k., për të marrë me qira objektin për arsye tregtare, rezulton në kundërshtim me të dhënat e kontratës së qirasë mes palëve, nr. *** rep., datë 30.9.2010, për apartamentin në Tropojë, e lidhur para noterit në Tiranë **për qëllime banimi, e cila** është e administruar në Komision.

56. Për sa më lart:

⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 3.4.2019.

¹⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 28.3.2019.

¹¹ Neni 72 f. i fundit i Kodit Civil.

¹² Shih aktet e publikuara në CN-277467-07-09.

¹³ Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

¹⁴ Sipas nenit 59 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Per procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”

a) Nuk përputhen deklaratimet e subjektit në pyetësor me kontratën e qirasë nr. *** rep., datë 30.9.2010, të lidhur për dhënie me qira të apartamentit në ***, me afat trevjeçar, me çmim 300 euro/muaj, pasi kontrata rezultoi e lidhur midis subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit K. K., si individ dhe ka pasur për qëllim banimin dhe jo ushtrimin e një aktiviteti tregtar nga shoqëria “***” sh.p.k., sikurse është deklaruar nga subjekti.

b) Duket se kontrata e lidhur mes subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit K. K., është fiktive. Çmimi i kontratës rezultoi i lartë dhe subjekti nuk arriti të bindë Komisionin lidhur me çmimin e lartë të kontratës, dhe as të dokumentojë përfitimin e të ardhurave prej saj.

c) Tatimi mbi të ardhurat është paguar nga subjekti i rivlerësimit dhe jo nga shoqëria “***” sh.p.k. Ai është paguar pas dy viteve që subjekti ka përfituar të ardhurat e pretenduara dhe nga dokumentacioni nuk rezultoi e paguar ndonjë gjobë për shkak të pagimit me vonesë të këtij tatimi e cila duket se është shmangur nga subjekti.

57. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

58. Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij lidhur me barrën e provës, sqaron:

“Sipas marrëveshjes, qiramarrësi më ka dorëzuar lekët paradhënie dhe unë i kam dorëzuar banesën, sipas kushteve të kërkuara prej tij, banesë e cila sipas thënieve të qiramarrësit do të përdorej në funksion të ushtrimit të një aktiviteti privat. Marrëveshja është formalizuar në kontratë qiraje, më datë 30.9.2010.

Në të gjithë legjislacionin tonë në fuqi, lidhur me referencat të shitjes dhe të qirave të banesave nuk ka çmim tavan referues, por ka çmim dysheme referues.”

58.1 Mbi dyshimet e Komisionit për fiktivitetin e kësaj kontrate, subjekti ka thënë se: *“Lidhur me dyshimin e ngritur që kontrata është fiktive ju provojmë si më poshtë:*

- *Banesa është në pronësinë time.*
- *Është paguar tatimi për këtë vlerë qiraje.*
- *Është kontrata e ligjshme me personin qiramarrës.*

*Bashkëlidhur po ju dërgoj bilancin kontabël të shoqërisë “***”, datë 31.12.2009, faturën e pagesës së tatimit për qiranë, datë 28.9.2012.”*

58.2 Subjekti i ka kërkuar Komisionit të thirret dhe të pyetet me cilësinë e dëshmitarit shtetasi K. H. K. Kjo kërkesë është refuzuar pasi trupi gjykues e çmon si të panevojshme këtë dëshmi, për sa kohë që vullneti i tyre është shprehur në kontratën e qirasë nr. *** rep., datë 30.9.2010 të lidhur para noterit publik, provë e administruar në dosjen e hetimit.

59. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti ndonjë argument apo provë të re për të bindur Komisionin lidhur me barrën e provës dhe dyshimet e ngritura lidhur me fiktivitetin e kontratës së lidhur mes palëve e cila ka qenë burim i shumës prej 10.800 eurosh, të cilat kanë shërbyer për blerjen e pasurisë garazh. Trupi gjykues, mbështetur në provat që disponoi, si dhe bindjen e brendshme, vendosi të mos i marrë në konsideratë të ardhurat nga qiraja në shumën prej 10.800 eurosh për blerjen e kësaj pasurie, duke vlerësuar se kontrata ka qenë fiktive.

60. Apartament banimi me sip. 59 m², ndodhur në lagjen “***”, ***, blerë në vitin 1993. Pjesa takuese: 50 %. Kjo pasuri është blerë përpara se subjekti të ketë filluar të ushtrojë detyrën e gjyqtarit; pasuri e cila është blerë nga Ndërmarrja Komonale Banesa, sipas kontratës së privatizimit, datë 15.7.1993, në vlerën 7.255 lekë.

61. Nga hetimi rezultoi se në deklaratën e pasurive (për vitin 2003), edhe në deklaratën “Vetting” nuk është paraqitur vlera e blerjes dhe burimi i krijimit të të ardhurave për apartamentin. Për këtë subjekti shpjegoi se *“... banesa në Tropojë është përfituar nga ligji i*

privatizimit dhe për vlerën e banesës nuk kërkohej të deklaroja, por me të ardhurat që familja ka pasur në atë periudhë kanë qenë plotësisht të mjaftueshme për ta privatizuar banesën, kjo provohet me librezat e punës depozituar në deklarinimin “Vetting”.”

→ Thëniet e subjektit ishin bindëse për trupin gjykues.

62. Automjet tip “Benz-200”, me vlerë 5.000 euro dhe zhdoganimi në vlerën 379.054 lekë, Pjesa takuese: 50 %. Kjo pasuri është fituar me kontratë shitblerjeje pasurie të luajtshme me nr. * rep., nr. *** kol., datë 18.1.2010.**

63. Lidhur me burimin e krijimit, subjekti ka deklaruar në deklaratën “Vetting” të ardhura nga pakësimi i gjendjes *cash* për vitet 2007 – 2008, burim i cili është deklaruar edhe në DPV-në e vitit 2010.

64. Komisioni përgatiti analizën financiare si më poshtë:

	Përshkrimi	Viti 2007	Viti 2008
1	PASURI	568 516	505 178
	Ndryshimi i likuiditetit (gjendje në fillim të vitit - gjendje në fund të vitit)	568 516	505 178
2	DETYRIME	-291 808	-300 684
	Shlyerje e kredisë për strehim për blerjen e apartamentit në Tiranë, nga “Raiffeisen Bank”	-291 808	-300 684
3	TË ARDHURA	1 426 087	1 517 415
	Të ardhura nga paga e subjektit, të dokumentuara	1 186 082	1 189 960
	Të ardhura nga bashkëshortja e subjektit, të dokumentuara	240 005	327 455
4	SHPENZIME	845 309	836 234
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	683 100	683 100
	Shpenzime interesi për shlyerjen e kredisë tek “Raiffeisen Bank”	146 009	137 134
	Shpenzime arsimimi Bachelor, E. M., Universiteti SHKODER	16 200	16 000
	REZULTATI FINANCIAR = Të ardhura - (Pasuri -Detyrime) - Shpenzime	-279 546	-124 680
	Kursime <i>cash</i> të deklaruara nga subjekti në DPV	500 000	500 000
	Aftësia REALE për të kursyer deri në fund të vitit	220 454	375 320

64.1 Në analizën financiare, te seksioni i pasurisë për vitin 2010, është pasqyruar vlera e këtij automjeti në shumën totale prej 1.073.104 lekësh, e cila përfshin vlerën e blerjes së automjetit 5.000 euro (konvertuar¹⁵ në lekë në shumën 694.050 lekë) sipas kontratës së shitjes në datën 18.1.2010, si dhe vlerën e zhdoganimit sipas deklaratës doganore me nr. ***, të datës 26.1.2010, në vlerën 379.054 lekë, deklaruar në deklaratën “Vetting” nga subjekti.

65. Nga analiza financiare duket se pavarësisht kursimeve *cash* të deklaruara nga subjekti në DPV-të e viteve 2007 dhe 2008, si burim i blerjes së automjetit në një total prej 1.000.000 lekësh, aftësia e tij reale për të kursyer ka qenë 595.773 lekë. Duke qenë se vlera e blerjes së automjetit ka qenë 1.073.104 lekë, duket se subjekti nuk e justifikon plotësisht, me burime të ligjshme, krijimin e kësaj pasurie, me një diferencë prej 477.331 lekësh.

66. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar bindshëm burimin e ligjshëm për krijimin e kësaj pasurie.

67. Subjekti nuk ka dhënë shpjegime lidhur me këtë situatë financiare negative. Në përfundim trupi gjykues vlerëson se subjekti ka qenë në pamundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie në vlerën prej - 477.331 lekë.

¹⁵ Sipas kursit mesatar të BSH-së në vitin 2010.

68. Pasuritë tokë arë të ndodhura në fshatin *** Tropojë, me sip. 4.400 m² dhe 2.063 m². Pjesa takuese: 50 %, deklaruar në DPV-në e vitit 2013 dhe në deklaratën “Vetting”. Pasuritë janë fituar me trashëgimi nga subjekti, sipas vendimit nr. *** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, datë 22.5.2012, me anë të së cilës është lëshuar dëshmia e trashëgimisë për të ëmën znj. Xh. I. M. Në vijim, në datën 2.9.2013 është nënshkruar kontrata e pjesëtimit nr. *** rep. dhe *** kol., midis trashëgimtarëve, ku subjekti ka përfituar këto pasuri me sipërfaqe, përkatësisht, 4.400 m² dhe 2.063 m², të cilat i ka regjistruar në ZVRPP-në Tropojë. *Pasuritë tokë arë janë fituar nga e ëma Xh. M., me AMTP-në nr. ***, datë 13.10.1999.*

69. Tokë arë në fshatin *** Tropojë, me sip. 6.828 m². Pjesa takuese: 50 %, deklaruar në DPV-në e vitit 2013 dhe në deklaratën “Vetting”. Kjo pasuri është fituar me kontratën e dhurimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.8.2013, nga e motra (nga babai) e subjektit znj. F. M. Pasuria është e regjistruar në ZVRPP-në Tropojë në pronësi të subjektit. *Pasuria tokë arë është fituar nga e motra me AMTP-në nr. ***, datë 11.10.1999.*

70. Në përfundim të hetimit rezultoi se përputhen deklaratimet e subjektit me dokumentacionin e administruar në dosje.

71. Gjatë hetimit është konstatuar se në DPV-në e vitit 2013 subjekti ka deklaruar shtesë tokë arë me sip. 1.000 m² ndodhur në fshatin ***, ***, ***, Durrës, e paregjistruar, e pandarë fizikisht, si trashëgimtar ligjor me të drejtë për të vazhduar procedurat ligjore për regjistrim. Pjesë takuese: 50 %. *Këtë pasuri subjekti nuk e ka deklaruar në deklaratën “Vetting”.*

Burimi i krijimit: deklaratë noteriale me nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 14 tetor 2013.

72. Nga ILDKPKI-ja është konstatuar: *Fshehje në deklaratën e pasurisë “Vetting” të tokës arë, me sip. 1.000 m², në fshatin *** ***, sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 14.10.2013, e cila është deklaruar në deklaratën e interesave private “Periodike/vjetore 2013”.*

73. Nga hetimi rezultoi se subjekti nuk e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratën “Vetting”. Në Regjistrin Noterial u evidentua regjistrimi i deklaratës noteriale me nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 14.10.2013 para noteres E. L. (D). Nga përmbajtja e deklaratës noteriale rezultoi se subjekti i rivlerësimit, bashkë me vëllezërit dhe nipërit si trashëgimtarë ligjorë të vëllait të subjektit të rivlerësimit, kanë deklaruar se kanë të trashëguar nga e ëma Xh. M., një pasuri me sip. 2.000 m², të ndodhur në ***, fshati ***, Bashkia ***, Durrës, e cila nuk është e regjistruar në emër të së ëmës në ZVRPP. Gjithashtu, deklaruesit kanë rënë dakord të ndajnë pjesët takuese midis tyre, ku subjekti do të përfitonte 1.000 m².

74. Nga ZVRPP-ja Durrës dhe ALUIZNI nuk ka rezultuar ndonjë pasuri e regjistruar apo vetëdeklaruar ndonjë objekt informal në emër të personit dhe personave të tij të lidhur për këtë pasuri.

75. Subjekti ka shpjeguar se: *“... nuk e kam deklaruar në deklaratën “Vetting”, pasi nuk jam pronar mbi këtë sipërfaqe toke, si dhe nuk kam asnjë të drejtë reale mbi të, sepse nuk është e përfituar në mënyrë ligjore. Nëna ime nuk është pronare e kësaj toke, prandaj nuk kemi kryer veprim për legalizimin e saj. Ne si trashëgimtarë ligjorë të nënës sonë kemi përpiluar një deklaratë noteriale, në momentin e ndarjes së trashëgimisë së nënës tonë, me qëllim që në të ardhmen të mos ketë konflikte... E kam deklaruar pranë ILDKPKI-së në atë periudhë, për të qenë në rregull, meqenëse kërkohej të deklaroheshin asetet e paregjistruara, por jo se jam pronar i saj. Lidhur me këtë sipërfaqe toke kam dhënë sqarimet e mia pranë ILDKPKI-së në vitin 2015.*

Unë nuk disponoj asnjë dokument ligjor për këtë sipërfaqe toke, pasi nëna jonë nuk ka qenë pronare e kësaj pasurie sepse nuk është e fituar sipas ligjit, dhe ky është shkaku që neve nuk kemi kryer asnjë investim në atë pasuri, sepse nuk kemi asnjë të drejtë reale mbi të.”

Subjekti i ka bashkëlidhur pyetësorit, deklaratën noteriale dhe një kopje të certifikatës së vdekjes të së ëmës.

76. Në përfundim të hetimit, trupi gjykues vlerësoi se subjekti ka paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi apo posedimi të tij. **Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.**

77. Subjekti në shpjegimet e tij është shprehur se: “Pasuria 1.000 m² tokë arë në ***, ashtu siç kam deklaruar, unë nuk kam asnjë të drejtë reale mbi të, kjo është provuar dhe nga ana e juaj, ku pas investigimit në zyrat shtetërore ka rezultuar që nëna ime nuk ka pasur tokë në pronësi apo përdorim në ***, ***, prandaj nuk mund të deklaroj një pasuri kur unë nuk e disponoj dhe nuk kam asnjë të drejtë reale mbi të. Deklarata noteriale, ashtu siç kam theksuar, është përpiluar në mënyrë që t’i paraprijmë çdo konflikti të mundshëm në të ardhmen mes trashëgimtarëve tanë.

78. Përfaqësuesi i subjektit në seancën dëgjimore iu përgjigj pyetjeve të Komisionit lidhur me këtë pasuri duke shpjeguar se: “... në momentin që sendi nuk ekziston, çdo lloj marrëveshjeje mbi të nuk ka vlerë. Lidhja me sendin nuk është ligjore, çdo lloj marrëveshjeje mbi të nuk ka vlerë juridikisht.”

79. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit duhet të kishte deklaruar në deklaratën “Vetting” lidhur me posedimin e paligjshëm mbi këtë pasuri, ashtu siç edhe e ka deklaruar në DPV-në e vitit 2013, mbështetur në të njëjtin arsyetim ligjor.

80. Gjatë administrimit të deklaratave vjetore, u vu re se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar adresë të tjera banimi nga pasuritë e deklaruara.

a) Në DPV-në e vitit 2005 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar adresë banimi, regjistruar në gjendjen civile: “****”, pallati ***, Njësia nr. ***, Tiranë; ndërkohë është transferuar në Gjykatën e Krimeve të Rënda Tiranë, për të ushtruar funksionin si gjyqtar në vitin 2004 dhe nuk ka pasur pasuri të deklaruara në emrin e tij dhe personave të lidhur, përveç apartamentit në ***.

b) Në DPV-në e vitit 2006 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar adresë të regjistruar në gjendjen civile: Rr. “****”, Tiranë (pra në adresën ku ka porositur apartamentin në këtë vit dhe blerë në vitin 2010).

81. Në pyetësorin e datës 27.3.2019, subjekti është pyetur në lidhje me transferimin e tij dhe të familjes në Tiranë, si dhe i është kërkuar dokumentacion justifikues për adresën e banimit, deri në vitin 2006; gjithashtu, është pyetur për datën e saktë kur është bërë i banueshëm apartamenti i blerë në Tiranë. Subjekti ka sqaruar në pyetësorin e datës 27.3.2019, se ka jetuar përkohësisht te vëllai i tij dhe më tej, nga muaji janar 2005 deri në muajin gusht 2006 ka banuar me qira në “Rrugën e ***”, ku ka paguar qiranë paradhënie me para në dorë, 400.000 lekë; njëkohësisht gjatë kësaj periudhe ka paguar ujë dhe drita për llogari të qiradhënësit, çdo muaj. Këtë adresë banimi e ka deklaruar dhe në deklaratimet e vitit 2005. Në shtator të vitit 2006 ka kaluar në banesën ku aktualisht banon, në rrugën “****”. Pjesëtarët e familjes kanë ardhur në Tiranë gradualisht pjesë, pjesë.

82. Komisioni ka përfshirë në analizën financiare si shpenzim për periudhën janar 2005 – gusht 2006, vlerën e qirasë në shumën 400.000 lekë, duke pranuar deklarin e subjektit.

83. Subjekti i rivlerësimit ka ndryshuar mbiemrin familjarisht nga Mulkurtaj në Mulkurti në datën 4.11.2009, referuar certifikatës familjare, datë 23.1.2017, administruar për këtë proces; fakt ky i pasqyruar në formularin e DSIK-së. Nga Komisioni është kryer një hetim në drejtim të verifikimit të ndonjë pasurie të padekluar apo të fshehur të subjektit, nisur nga fakti i ndryshimit të mbiemrit.

84. Nga hetimi nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë apo indice.

Pasuritë financiare

85. Subjekti ka deklaruar në deklaratën “Vetting” se zotëron në banesë gjendje *cash* në vlerën 1.500.000 lekë nga kursimet familjare.

86. Nga deklaratimet e subjektit në deklaratat periodike vjetore rezultoi se gjendja *cash* progresive në fund të vitit financiar 2016, ishte 2.700.000 lekë.

Viti i deklarimit	Gjendje <i>cash</i> në fund të çdo viti	Përshkrimi në deklaratën periodike vjetore
2003	0	Nuk deklarohet <i>cash</i>
2004	0	Nuk deklarohet <i>cash</i>
2005	500 000	Gjendje <i>cash</i> në banesë, shtesë për 2005
2006	0	Pakësim gjendje <i>cash</i> 500,000 lekë për blerjen e apartamentit
2007	500 000	Shtesë 500,000 lekë gjendje <i>cash</i> në banesë
2008	1 000 000	500,000 lekë shtesë 2008, gjendje <i>cash</i> në banesë
2009	1 500 000	500,000 lekë shtesë 2009, gjendje <i>cash</i> në banesë
2010	0	Pakësim i gjendjes <i>cash</i> të deklaruar për vitet 2007 - 2008 - 2009, vlera 1.500.000 lekë.
2011	1 200 000	Gjendje <i>cash</i> në banesë, shtesë 2011
2012	1 700 000	Shtesë 2012, gjendje <i>cash</i> në banesë - 500.000 lekë
2013	2 000 000	Shtesë 2013, gjendje <i>cash</i> në banesë = 300.000 lekë
2014	3 490 660	Shtesë 2014, gjendje <i>cash</i> në banesë = 650.000 lekë; Shtesë 6.000 euro nga shitja e automjetit "Ford Fiesta", gjendje <i>cash</i> në banesë, vajza E. M., sipas kont. Nr. ***, datë 22.10.2014, me përshkrim "likuidim <i>cash</i> para nënshkrimit të kontratës".
2015	2 700 000	Shtesë 2015, gjendje <i>cash</i> në banesë nga të ardhurat viti 2015 = 50.000 lekë; Pakësim <i>cash</i> shuma 6,000 euro nga shitja e makinës pasi vajza është martuar, sipas deklarimit në DPV-në 2014.
2016	2 700 000	Nuk deklarohen ndryshime të gjendjes <i>cash</i> .
Veting	1 500 000	Gjendje <i>cash</i> në banesë nga kursimet.
DIFERENCA	1 200 000	Diferencë në deklarim <i>cash-i</i>

87. Nisur nga kjo mospërputhje, subjekti u pyet në pyetësorin e datës 27.3.2019, i cili konfirmoi gjendjen *cash* në datën 31.12.2016, në vlerën 1.500.000 lekë, duke shpjeguar se të gjitha të ardhurat familjare deri në dhjetor të vitit 2011 i kishte përdorur për blerjen e aseteve familjare dhe kompletimin me pajisje, fakt të cilin e kishte deklaruar pranë ILDKPKI-së në vitet 2012 dhe 2015.

88. Subjekti ka sqaruar se ndryshimi i gjendjes *cash* dhe mospërputhja kanë ndodhur pasi deklarimi i gjendjes *cash* në vitin 2011 nuk është i saktë dhe se kjo është pasqyruar në deklaratimet e bëra prej tij në ILDKPKI në vitin 2012. Subjekti ka sqaruar se nuk ka pasur gjendje *cash* në fund të viti 2011, duke bashkëlidhur edhe deklaratimet përkatëse pranë ILDKPKI-së.

89. Mbështetur në këto sqarime të subjektit, të cilat rezultuan të provuara edhe nëpërmjet dokumentacionit, deklarimi “Vetting” për gjendjen *cash* në vlerën 1.500.000 lekë, është i saktë.

90. Likuiditete në llogarinë rrjedhëse në “Raiffeisen Bank” në vlerën 720.000 lekë.

91. Konfirmohet kjo llogari nga “Raiffeisen Bank”. Sipas informacionit, gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2016 ka qenë 700.497,28 lekë.

92. Deklaruar në deklaratën “Vetting”, kredi e marrë në “Raiffeisen Bank” për blerje banese, me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.10.2006, në vlerën 5.000.000 lekë. Detyrimi i mbetur i kredisë është **1.316.770 lekë**.

93. Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar.

94. Në deklaratën periodike të vitit 2014, subjekti deklaroi se më 27.12.2014 ka kryer shpenzime në *cash* për darkën e dasmës së vajzës së tij E. M., në vlerën 1.200.000 lekë, të cilat e kanë burimin nga të ardhurat e 260 pjesëmarrësve në dasëm.

Në analizën financiare të këtij viti, kjo shumë është përlogaritur si shpenzim dhe njëkohësisht si të ardhura, duke pasur një impakt 0 lekë në rezultatin e vitit.

95. Nga analiza financiare e kryer nga njësia e shërbimit ligjor duket se subjekti nuk ka pasur mundësi për parapagimin e të gjithë vlerës së deklaruar të shpenzimeve të dasmës, pasi në fund të vitit 2014 aftësia reale e kursimit ka qenë 876.145 lekë (shiko analizën financiare 2003 – 2016).

96. **Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar lidhur me këtë çështje se:** “... për dasmën e vajzës E., me sa mbaj mend, në momentin e prenotimit të lokalit unë kam parapaguar 10.000 lekë dhe në përfundim të dasmës, sipas zakonisht, si organizator kam grumbulluar të ardhurat, duke likuiduar shpenzimet pa u larguar nga lokali.”

→ Thëniet e subjektit ishin bindëse për trupin gjykues.

97. Gjatë hetimit është konstatuar se subjekti ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore të ardhurat e tij si dhe të personave të lidhur (familjarëve), por nuk ka deklaruar llogaritë bankare të tyre (bashkëshortes dhe fëmijëve).

98. Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezultojnë llogaritë e mëposhtme bankare të familjarëve:

a) **Sh. M.**, bashkëshortja e subjektit është kliente e “Credins Bank” sh.a.¹⁶ dhe zotëron llogarinë bankare me nr. *** në monedhën lekë. Kjo llogari është përdorur për përfitimin e pagës nga puna pranë Poliklinikës nr. *** Tiranë. Gjendja e saj në datën 31.12.2016 është 80 lekë.

b) **E. M.**, ka qenë kliente e “Bankës Kombëtare Tregtare”¹⁷ dhe ka pasur llogari bankare si vijon:

- Llogaria me nr. *** në monedhën lekë e cila është përdorur nga e bija e subjektit për përfitimin e pagës nga puna pranë Shërbimit të Provës Tiranë, në periudhën 1.2.2011 – 28.1.2015.

- Llogaria me nr. *** në monedhën euro, ka qenë aktive në periudhën 7.10.2013 – 24.11.2014. Në këtë llogari u konstatua një derdhje në shumën prej 6.000 eurosh (konvertuar në 841.260 lekë¹⁸) nga vajza E. M., në datën 7.10.2013, shumë e cila është tërhequr përsëri brenda muajit nëntor të vitit 2013. Është pyetur subjekti në lidhje me burimin e kësaj shume meqenëse, në këtë vit, vajza e tij nuk ka qenë në marrëdhënie pune dhe ai ka deklaruar¹⁹ se, e bija e ka derdhur këtë shumë si garanci për efekt vize dhe më pas e ka tërhequr; burimi i kësaj shume janë kursimet familjare në *cash* të deklaruara në DPV-të e viteve 2012 dhe 2013.

Sipas deklarimeve të subjektit në këto vite, subjekti ka kursyer shumën *cash* prej 800.000 lekësh në periudhën 2012 – 2013 (500.000 lekë në fund të 2012, dhe 300.000 lekë në fund të 2013), në një total prej 800.000 lekësh.

Nga analiza e gjendjes cash që subjekti i rivlerësimit ka pasur realisht mundësi të kursejë për vitet 2012 dhe 2013, me një vlerë totale prej 35.485 lekësh, duket se subjekti nuk ka pasur mundësinë financiare për ta kryer këtë transaksion.

c) **E. M.**, ka qenë kliente e “Credins Bank” sh.a. dhe ka pasur një llogari bankare si dhe katër karta të parapaguara në monedhën lekë, si vijon:

- Llogaria rrjedhëse me nr. *** në monedhën lekë është aktivizuar në datën 9.2.2017²⁰ dhe është përdorur për përfitimin e pagës nga puna pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

¹⁶ Shkresa nr. *** prot., datë 11.2.2019.

¹⁷ Shkresa nr. *** prot., datë 3.12.2018.

¹⁸ Sipas kursit mesatar të BSH-së në vitin 2014.

¹⁹ Pyetësori datë 27.3.2019, pika 4.4

²⁰ Pas plotësimit të deklaratës “Vetting”.

- Kartat e parapaguara me nr. ***, ***, *** dhe ***. Vërehet se ato janë përdorur në periudhën 2014 – 2017 për blerje online të artikujve të ndryshëm jashtë vendit. Vlera totale e këtyre blerjeve për çdo periudhë deklarimi është përfshirë në analizën financiare, te seksioni i shpenzimeve.

E. M., ka qenë gjithashtu kliente e “Raiffeisen Bank” dhe ka pasur një llogari bankare si dhe dy llogari për tërheqje *Mastercard* si vijon:

- Llogari me nr. *** në monedhën lekë, e cila është përdorur për përfitimin e pagës nga puna pranë Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë.

- Llogari bankare me nr. *** në monedhën euro, në të cilën gjatë muajit shtator të vitit 2014 janë kryer tre derdhje, të cilat së bashku arrijnë vlerën 1.000 euro.

Është pyetur subjekti në lidhje me burimin e këtyre shumave, meqenëse në këtë vit vajza e tij nuk ka qenë në marrëdhënie pune dhe ai deklaroi në pyetësonin e datës 27.3.2019 (përgjigjia nr. 5), se këto derdhje lidhen me disa aktivitete bamirësie që e bija dhe një grup shokësh të saj kanë organizuar gjatë vitit 2014. Subjekti ka paraqitur foto të aktiviteteve të mësipërme si dhe kopje të ekstraktit të llogarisë bankare në emër të së bijës (për më tepër referojuni pyetësonit). Gjendjet e llogarive të mësipërme bankare janë përfshirë në analizën financiare, në çdo vit financiar.

99. Subjekti nuk ka deklaruar numrat e llogarive dhe vlerën e likuiditeteve në llogari bankare për personat e lidhur, në zbatim të detyrimit sipas ligjit nr. ***, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.

100. Nga dokumentacioni i administruar në dosje²¹ rezultoi se e bija e subjektit *E. M.* ka studiuar pranë Universitetit të Shkodrës “****” me kohë të plotë në periudhën 2006 – 2008, dhe se në vitin akademik 2008 është transferuar nga ky universitet. Analiza financiare përfshin tarifën e studimit për vitet 2007 dhe 2008.

101. Lidhur me shpenzimet e jetesës për periudhën 2006 – 2008, subjekti ka deklaruar²² se vajza e tij i ka ndjekur studimet nga Tirana, dhe në rastet kur ka qëndruar në Shkodër, ka banuar tek vajza e vëllait të subjektit, D. M., e cila vazhonte studimet pranë të njëjtit universitet. Subjekti nuk deklaroi vlerë specifike për shpenzimet e akomodimit, por shprehet se nuk ka paguar qira për vajzën dhe se ka përballuar shpenzime vetëm për tarifën si studente dhe lëvizjet me autobus.

102. Subjekti ka deklaruar në DPV-në e vitit 2013 dhe në pyetësonin nr.1 se ka paguar tarifën e studimit për të bijën *E. M.*, për Masterin e ndjekur pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, Tiranë. Ky institucion konfirmoi²³ pagesën e shumës prej 150.000 lekësh.

103. Nga deklaratimet e subjektit dhe nga dokumentacioni i administruar në dosje²⁴ është konstatuar se e bija e subjektit *E. M.*, ka kryer studimet Bachelor dhe Master në periudhën akademike 2010 – 2015, pranë Universitetit *** të Tiranës. Në analizën financiare këto shpenzime janë paraqitur sipas datave dhe pagesave të konfirmuara nga institucioni (***).

104. Subjekti deklaroi se ai dhe familjarët e tij kanë kryer udhëtime të shpeshta në vendlindjen e tij, Tropojë dhe për këtë arsye kanë kaluar tranzit në pikat kufitare Morinë, Qafë Prush dhe Qafë Morinë. Për këto udhëtime, në analizën ekonomike janë përlllogaritur vetëm shpenzimet e transportit²⁵.

²¹Shkresë nr. *** prot., datë 28.2.2019, nga Universiteti i Shkodrës “****”.

²²Shiko pyetësonin e datës 27.3.2019, përgjigjia nr. 4/5.

²³Shkresë nr. *** prot., datë 27.2.2019 nga Fakulteti i Shkencave Sociale.

²⁴Shkresë nr. *** prot., datë 25.2.2019 dhe shkresën nr. *** prot., datë 25.2.2019 nga Universiteti *** i Tiranës.

²⁵Përlllogaritur shpenzime karburanti për destinacionin Tropojë: 500 km Tiranë -Tropojë vajtje-ardhje, 9,5 l/100 km, 1,2 euro/l = përafërsisht 50 (shënuar te tabela TIMS).

105. Në analizën financiare janë përlogaritur shpenzimet e udhëtimit sipas informacionit të marrë nga sistemi TIMS për periudhën 2009 – 2016 dhe njëkohësisht, duke përfshirë edhe informacionin e dhënë nga vetë subjekti në pyetësor.

106. Subjekti ka deklaruar në pyetësorin nr. 1 dhe pyetësorin nr. 3²⁶ se një pjesë e udhëtimeve të kryera nga familjarët e tij janë financuar nga individë të ndryshëm, të paraqitur në mënyrë të detajuar në tabelësi më poshtë:

Financime nga palë të treta - sipas pyetësorit nr.1 dhe pyetësorit nr. 3	2011	2012	2013	2014	2015	TOTALI
E. M., financim udhëtim Suedi për Sh., dhe E. M., 11.8.2015 – 25.8.2015; udhëtim E. M., Suedi, 14.9.2015 – 20.9.2015					1 260 €	1 260 €
I fejuari i E. M., udhëtim Korfuz, 16.5.2013 – 18.5.2013; udhëtim në Evropë 7.7.2013 – 12.7.2013			610 €			610 €
E. L., banuese në Paris (Francë) - Udhëtimi E. M., 2.4.2014 – 5.4.2014				260 €		260 €
E. G., udhëtim E. M., 17.10.2014 – 19.20.2014 Vjenë; udhëtim E. M., Gjermani 29.6.2014 – 10.7.2014; udhëtim E. M., Romë 19.12.2015 - 24.12.2015				600 €	200 €	800 €
E. G., financim udhëtime E. M., (2011 – 2014)	920 €	3 230 €	2 380 €	3 860 €		10 390 €
Një mik i E. M., (nuk specifikohet identiteti) E. M., udhëtim Amsterdam 29.10.2015 – 2.11.2015					200 €	200 €
Totali në EURO	920 €	3 230 €	2 990 €	4 720 €	1 660 €	13 520 €
Totali Dhurata nga të Tretët në LEKË	127 236	451 296	419 228	661 319	228 499	1 887 578

107. Vlera e shpenzimeve për këto udhëtime është përfshirë në analizën financiare të subjektit, pasi ai nuk vuri në dispozicion dokumentacion provues ligjor mbi mundësitë financiare të personave që kanë financuar këto udhëtime.

108. Në analizën financiare nuk janë përfshirë shpenzimet e udhëtimit të financuara nga e bija e subjektit, E. M., në vitin 2015, meqenëse nga hetimi rezultoi se ajo ka pasur burime të mjaftueshme financiare nga shitja e automjetit në vitin 2014.

109. Personi i lidhur me subjektin, e bija znj. E. M., në deklaratën “Vetting”, deklaroi të ardhura nga shitja e automjetit me kontratën nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 22.10.2014, në vlerën 6.000 euro. Pjesë takuese: 100 %. E. M., ka deklaruar në DPV-në e vitit 2011 automjet tip “Ford”, vit prodhimi 2006, me vlerë reference 6.000 euro. Kjo pasuri është fituar nëpërmjet kontratës së dhurimit me nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 26.12.2011 nga i fejuari i saj, pa kundërshtim.

110. Pas hetimit të kryer nga Komisioni rezultoi se me kontratën e dhurimit nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 26.12.2011, shtetasi E. G., i dhuron E. M., një automjet “Ford”, tipi ***, ngjyrë gri, të vitit 2006.

111. Sipas deklaratës doganore nr. ***, datë 16.12.2011, vlera e këtij automjeti është 1.000 euro ose 139.740 lekë (vlerë e cila konfirmohet edhe nga fatura e blerjes në gjuhën gjermane, lëshuar nga shitësi L. M., në datën 12.12.2011 kundrejt shtetasit E. G.) Ndërkohë, sipas kësaj deklarate doganore, është përdorur çmimi i referencës në vlerën 546.985 lekë për përlogaritjen e detyrimeve doganore, si dhe rezultoi se vlera e detyrimeve doganore të paguara nga dhuruesi i automjetit, E. G., është 109.396 lekë, pra, rezultoi se vlera totale e referencës së këtij automjeti është 656.381 lekë.

112. Në analizën financiare të vitit 2011, ky automjet është paraqitur te seksioni i pasurive me vlerën totale prej 249.136 lekësh, e cila përfshin vlerën reale të blerjes nga shtetasi E. G., dhe vlerën e detyrimeve doganore të paguara sipas deklaratës doganore. Njëkohësisht, për efekt të dhurimit, kjo vlerë është paraqitur edhe te seksioni i të ardhurave, duke pasur impakt 0 lekë në rezultatin e përlogaritjes për vitin 2011.

²⁶ Pyetësori datë 27.3.2019.

113. Me kontratën e shitblerjes me nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 22.10.2014, E. M., i kalon pronësinë mbi automjetin shtetasit A. Q. Çmimi i shitblerjes sipas kësaj kontrate është përcaktuar në shumën 6.000 euro (ose 840.660 lekë²⁷), çmim i cili sipas kontratës është likuiduar para nënshkrimit të saj.

114. Subjekti ka deklaruar në deklaratën “Vetting” dhe në deklaratat periodike të viteve 2015 dhe 2016, se vajza e tij E., përfiton ndihmë nga shteti suedez për rritjen e fëmijës së saj, si dhe zotëron një llogari bankare pranë bankës SEB në Suedi. Gjendja e deklaruar në deklaratën “Vetting” është në vlerën 6.800 korona suedeze.

115. Subjekti ka paraqitur dokumentacion justifikues mbi mundësitë financiare të vajzës së tij në Suedi.

116. Duke konsideruar faktin se vajza është shkëputur nga trangu familjar, kjo llogari nuk është përfshirë në analizën financiare të subjektit për procesin e rivlerësimit.

117. Komisioni ka përlllogaritur në analizën financiare për subjektin e rivlerësimit shpenzime jetike vjetore sipas metodologjisë së përdorur nga ILDKPKI-ja²⁸ gjatë kontrollit të deklaratës së pasurisë së subjektit, z. Idriz Mulkurti. Ky institucion konfirmoi se shpenzimet jetike i referohen treguesve statistikorë të përlllogaritur nga INSTAT dhe ka vënë në dispozicion vlerat e konsumit vjetor/frymë për periudhën 2003 – 2016.

Nga shqyrtimi i këtyre të dhënave rezulton se për vitin 2007 është përdorur një vlerë shumë e lartë krahasuar me vitet e tjera të përfshira në analizë (235.968 lekë konsum vjetor/frymë), ndërkohë që, në vitet pasardhëse, 2008 – 2011, konsumi/frymë ka vlerën 136.620 lekë. Për këtë arsye, në analizën financiare të subjektit, për vitin 2007 është përdorur vlera e shpenzimeve jetike të vitit 2008.

²⁷ Sipas kursit mesatar të BSH-së në vitin 2014.

²⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 21.2.2019 nga ILDKPKI-ja.

Analiza financiare e përgatitur nga Komisioni për vitet 2003 - 2016

Subjekti I rivlerësimit IDRIZ MULKURTI	Para 2003	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	TOTAL
PASURI	7 255	0	0	633 290	5 716 212	568 516	505 178	415 496	1 431 530	212 014	554 448	297 468	1 242 911	-299 505	200 295	11 477 854
Apartament 59 m2 ne B. Curri deklaruar 0 lek ne DVP dhe Vetting	7 255															0
Apartament 84 m2, rr. "xxx", Tirane, blere ne 2006 (92 m2 me amb. perbashketa)					6 259 372											6 259 372
Automjet "Benz C200", targa xxx, blere ne 18.01.2010									1 073 104							1 073 104
Garazh 22.2 m2, rr. "xxx", Tirane, blere ne 2010									1 943 340							1 943 340
Automjet "Ford Fiesta", targa xxx, dhurate vajzes E.M nga I fejuari E.G.										249 136			-249 136			0
Diference LIKUIDITETI (Lik. Aktual - Lik. Viti paraardhes)		0	0	633 290	-543 160	568 516	505 178	415 496	-1 584 914	-37 122	554 448	297 468	1 492 047	-299 505	200 295	2 202 038
LIKUIDITETE (FUND VITI Dokumentuar)	0	0	0	633 290	90 131	658 647	1 163 825	1 579 321	-5 593	-42 715	511 733	809 201	2 301 248	2 001 743	2 202 038	
DETYRIME	0	0	0	0	5 000 000	-291 808	-300 684	-309 829	80 747	-728 963	-338 969	-349 279	-359 903	-370 849	-800 963	1 229 501
Kredi per strehim, per blerjen e ap. ne Tirane nga Raiffeisen Bank	0	0	0	0	5 000 000	-291 808	-300 684	-309 829	-319 253	-328 963	-338 969	-349 279	-359 903	-370 849	-800 963	1 229 501
Detyrim ndaj "xxx" shpk diferenca prej 3,200 euro per garazhin e blere ne vitin 2010									400 000	-400 000						
PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)	7 255	0	0	633 290	716 212	860 324	805 861	725 325	1 350 783	940 978	893 417	646 747	1 602 814	71 344	1 001 258	10 248 353
TE ARDHURA	0	953 223	1 460 612	1 210 248	1 254 079	1 426 087	1 517 415	1 514 398	1 816 983	2 533 011	2 239 435	2 110 546	4 302 762	2 269 559	2 539 522	26 556 356
Te ardhura te dokumentuara SR		781 188	1 287 695	1 127 943	1 083 595	1 186 082	1 189 960	1 168 872	1 435 654	1 314 133	1 352 180	1 361 017	1 563 222	1 642 737	1 697 333	18 191 611
Te ardhura te dokumentuara bashkeshortja SR		172 035	172 917	82 305	170 484	240 005	327 455	345 526	381 329	411 294	430 286	459 639	493 044	453 383	452 148	4 591 850
Te ardhura nga punësimi E.M.(Vajza SR)	0	0	0	0	0	0	0	0	0	558 448	456 969	289 890	454 972	0	0	1 760 279
Te ardhura nga punësimi E.M. (Vajza SR)	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	345 041	345 041
Shpërbllim Bashkia Tirane si student ekselence E.M. (Djali SR)															45 000	45 000
Te ardhura CASH nga qiraja e apartamentit në Lagjen "xxx", B.Curri - e parapaguar per te gjithë periudhen									0							0
Te ardhura nga dhurimi i automjetit "Ford Fiesta" vajzes SR nga I fejuari E. G.										249 136						249 136
Te ardhura nga financimet e udhëtimeve jashte vendit, nga E.M.														173 439		173 439
Te ardhura nga dasma e vajzes E.M. me 27.12.2014 (260 te ftuar)													1 200 000			1 200 000
Te ardhura nga shitja e automjetit "Ford Fiesta" te vajzes E.M.													591 524			591 524
Nr. Persona	5	5	5	5	5	5	5	5	5	5	5	5	5	4	4	
SHPENZIME	0	469 820	955 820	547 785	547 785	845 309	836 234	829 705	1 246 856	2 074 465	1 810 533	1 857 126	3 981 236	1 812 171	1 225 759	18 053 185
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI	0	469 820	469 820	547 785	547 785	683 100	683 100	683 100	683 100	683 100	697 740	705 120	1 099 990	897 104	940 368	9 321 212
Shpenzime për qira Tiranë parapagim janar 2005-gusht 2006 sipas pyetesorit dt 27.03.2019 dhe dt. 01.05.2019			400 000													
Shpenzime interesi per shlyerjen e kredise tek Raiffeisen Bank						146 009	137 134	127 988	118 564	108 854	98 848	88 538	77 915	66 968	44 139	1 014 958
Shpenzim për pasaportën (sipas vërtetimeve të pagave viti 2009)								4 900								4 900
Shpenzime udhëtimi jashte vendit - TIMS								13 717	154 079	302 186	551 195	597 996	1 110 372	479 022	135 946	3 344 513
Shpenzime per dietat e marra (sipas vërtetimeve të pagave)			86 000													86 000
Shpenzim per tatimin ne burim per qirane e ap. ne Tropoje											148 379					148 379
Shpenzime per takse shitje apartamenti dhe garazhi paguar per ZVRPP ne 28.06.2010									117 600							
Shpenzim per pagesen e faturave te OSHEE per ap. ne B.Curri sipas kont.s se qirase														34 322		34 322
Shpenzim per nderhyrje mjekesore E.M.													153 307			153 307
Shpenzime arsimimi ne Londer xxx E.M.																0
Shpenzime per testin e gjuhes angleze E.M. dhjetor 2017																0
Shpenzime në Londër E.M. (viza & siguracioni, per tre vite shkollore)																0
Shpenzime në Londër E.M. (transport, veshmbathje, etj) shtator - dhjetor 2018																0
Shpenzime arsimit Bachelor dhe Master ne XXX per vajzen, E.M.									173 513	380 325	314 370	315 473	210 165			1 393 845
Shpenzime arsimimi Universiteti XXX Tirane, E.M.																0
Shpenzime arsimit Master per vajzen, E.M., universiteti TIRANE												150 000				150 000
Shpenzime arsimimi Bachelor E.M., universiteti SHKODER						16 200	16 000									32 200
Shpenzime mobilimi apartamenti sipas pyetesorit date 02.05.2019										600 000						600 000
Blerje jashte vendit me karte debiti CREDINS Bank - E.M.													129 488	334 755	105 306	569 548
Shpenzime per blerje me karte debiti RAIFFEISEN Bank - E.M.																0
Shpenzime per dasmen e vajzes E.M. me 27.12.2014													1 200 000			1 200 000
Rezultati financiar i dokumentuar (Te ardhura - Pasuri Neto - Shpenzime)	483 403	504 792	29 173	-9 918	-279 546	-124 680	-40 632	-780 656	-482 431	-464 515	-393 327	-1 281 288	386 044	312 505		
Kursime CASH te deklaruar nga subjekti ne DPV	-	-	500 000	500 000	500 000	500 000	500 000	500 000	-	-	500 000	300 000	650 000	50 000	-	-
Aftesia reale per te kursyer	0	0								0	35 485	0	0	50 000		

118. Nga analiza financiare e përgatitur nga njësia e shërbimit ligjor për periudhën 2003 – 2016, rezultoi se për vitet 2006, 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013 dhe 2014, ka një rezultat negativ në vlerën totale prej – 3,856,994 lekë, e pajustificuar me burime të ligjshme.

119. Nga analiza financiare, duket se subjekti nuk ka pasur mundësi të kursejë nga të ardhurat e ligjshme shumë *cash* prej 1.500.000 lekësh, të deklaruar në deklaratën “Vetting”, deri në datën 31.12.2016, por vetëm shumë 85.485 lekë (shumë kjo që mbartet në analizën financiare për vitet 2017 – 2018).

120. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

121. Lidhur me shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur për vitet 2017 – 2018 ka rezultuar si vijon:

I. Mbi shpenzimet e arsimimit të vajzës së subjektit, E. M.

Subjekti deklaron në pyetësonin nr. 1, se e bija E. M., ka ndjekur studimet pranë Universitetit *** të Tiranës, Fakulteti Juridik, në periudhën akademike 2016 – 2018, me vlerën totale prej 1.500 eurosh, e cila është paguar në vitin 2017.

Universiteti *** i Tiranës konfirmon²⁹ se studentja E. M., ka paguar shumë 1.500 euro për tarifën e shkollimit në datën 27.3.2018, e cila është pasqyruar te seksioni i shpenzimeve në analizën financiare të vitit 2018.

II. Mbi shpenzimet e arsimimit të djalit të subjektit, E. M.

Në vijim të deklarimeve të subjektit në pyetësonin nr. 1 dhe shqyrtimit të transaksioneve bankare pranë “Credins Bank”, rezulton se djali i subjektit, E. M., ka filluar studimet universitare në Londër, Mbretëria e Bashkuar, gjatë vitit 2018, pranë *** University (***) dhe ka paguar tarifën e studimit në vlerën 11.222 paund (1.575.905 lekë) nëpërmjet llogarisë bankare në emër të tij pranë “Credins Bank”. ***Subjekti ka sjellë dokumentacionin provues*** lidhur me këto pagesa. Kjo tarifë është përfshirë në analizën financiare, tek shpenzimet e vitit 2018.

Nisur nga ky konstatim, Komisioni ka përgatitur analizën financiare për vitet 2017 –2018 e cila është bazuar tek të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit dhe familjarëve të tij, sipas deklarimeve të subjektit dhe sipas llogarive të tyre bankare.

122. Në lidhje me shpenzimet e jetesës së djalit të tij në Londër, subjekti deklaron se i biri banon pranë djalit të motrës së subjektit, N. Gj., dhe se shpenzimet e jetesës janë normale, pasi nuk paguan për akomodimin.

123. Subjektit të rivlerësimit i është kërkuar dokumentacion justifikues në lidhje me vendbanimin e djalit të tij si dhe mbi shpenzimet mujore të jetesës. Subjekti ka deklaruar se i biri jeton me nipin e tij N. Gj., dhe bashkëshorten znj. N. Gj., dhe ka paraqitur një deklaratë në gjuhën angleze, ku ky çift deklaroi se E. M., jeton me ta dhe se ata po e mbështesin nga ana financiare duke i mbuluar shpenzimet e akomodimit, ushqimit etj.

124. Subjekti ka paraqitur dokumentacion mbi burimin e ligjshëm të të ardhurave të të afërmeve të tij në Londër, si dhe kontratën e qirasë në lidhje me adresën e deklaruar:

- Pagesën e kësteve të kredisë të banesës së deklaruar³⁰ në emër të N., dhe N. Gj., për periudhën tetor 2016 – shtator 2017.
- Faturën e furnizimit me ujë të muajit mars të vitit 2019 të emër të shtetasit N. Gj.
- Kontrata punësimi midis shtetasit N. Gj., dhe “**** (***)” Ltd, e datës 23.3.2006, shtetases N. Gj., dhe “Allied Irish Banks”.

²⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 27.3.2019 nga Universiteti *** i Tiranës.

³⁰ Sipas vërtetimit të lëshuar nga institucioni financiar “****”.

- Deklaratat e të ardhurave personale të shtetasve N., dhe N. Gj., për vitin 2017.

125. Subjekti është pyetur lidhur me shpenzimet mujore të jetesës së të birit ku ka deklaruar se shpenzimet mujore janë 215 - 220 paund/muaj, për transport, veshje etj, dhe se nga muaji mars i vitit 2019 ai punon dy herë në javë, sipas rregullave të shkollës. Subjekti ka paraqitur kopje të llogarisë bankare të të birit në gjuhën angleze, ku vërehen derdhje të përmuajshme në periudhën shtator 2018 – shkurt 2019.

126. Subjekti, gjithashtu, ka deklaruar se shpenzimet e jetesës për periudhën shtator – dhjetor 2018 kanë qenë përafërsisht 780 paund (ose 107.188 lekë) dhe janë përballuar nga të ardhurat familjare. Kjo vlerë është përfshirë në analizën financiare të shpenzimet e vitit 2018.

127. Në analizën financiare janë përlllogaritur shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit, sipas informacionit të marrë nga sistemi TIMS për periudhën 2017 – 2018 dhe njëkohësisht, duke përfshirë informacionin e dhënë nga vetë subjekti në pyetësor. Në lidhje me kalimet nga pikat kufitare Morinë, Qafë Prush dhe Qafë Morinë, për subjektin dhe familjarët e tij janë përlllogaritur shpenzime transporti sipas metodologjisë së përdorur edhe për periudhën 2003 – 2016. Gjithashtu, janë përlllogaritur shpenzime për udhëtimet jashtë vendit për familjarët e tij.

128. Nga hetimi është konstatuar se në datën 18.6.2018, subjekti ka kryer derdhje *cash* në llogarinë e tij bankare në “Raiffeisen Bank” në vlerën 1.410.000 lekë, me përshkrimin "*Derdhje nga I. Mulkurti, kursime për studimet e djalit jashtë vendit, deklaratë*".

129. Subjekti ka deklaruar se kjo shumë është derdhur në llogarinë e tij bankare si pakësim i gjendjes *cash* në banesë, të deklaruar në deklaratën “Vetting” dhe se burimi i tyre janë kursimet familjare të deklaruara ndër vite.

130. Nga analiza financiare për periudhën 2003 – 2016 (periudha e deklarimit) duket se subjekti nuk ka pasur mundësi të krijojë me burime të ligjshme shumë *cash* prej 1.500.000 lekësh, të deklaruar në deklaratën “Vetting”, por vetëm shumë prej 85.485 lekësh.

131. Komisioni, në vijim të informacioneve të përfituara nga përgjigjet e pyetësorëve dhe transaksionet bankare të subjektit, përgatiti analizën financiare për vitet 2017 – 2018, e cila rezultoi si vijon:

	Përshkrimi	2017	2018
1	PASURI	886 375	554 965
	Ndryshimi i likuiditetit (Gjendje në fillim të vitit - gjendje në fund të vitit)	886 375	554 965
2	DETYRIME	-293 690	-277 798
	Kredi për strehim, për blerjen e ap. në Tiranë nga “Raiffeisen Bank”	-293 690	-277 798
3	TË ARDHURA	2 564 610	2 616 303
	Të ardhura nga paga subjekti, të dokumentuara	1 590 134	1 510 672
	Të ardhura nga bashkëshortja, të dokumentuara	427 919	465 626
	Të ardhura nga punësimi E. M. (vajza e subjektit)	526 557	615 005
	Shpërblim Bashkia Tiranë si student ekselence E. M. (djali i subjektit)	20 000	25 000
4	SHPENZIME	1 421 557	3 198 262
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	940 368	881 595
	Shpenzime interesi për shlyerjen e kredisë tek “Raiffeisen Bank”	32 869	23 825
	Shpenzime udhëtimit jashtë vendit - sipas sistemit TIMS	272 548	165 917
	Shpenzime për testin e gjuhes angleze E. M., dhjetor 2017	27 484	
	Shpenzime arsimimi në London *** University, E. M.	0	1 575 905
	Shpenzime në Londër E. M. (viza & siguracioni, për tre vite shkollore)	0	136 258
	Shpenzime në Londër E. M. (transport, veshmbathje, etj) shtator – dhjetor 2018		107 188
	Shpenzime arsimimi Universiteti *** Tiranë, E. M.	0	185 175
	Blerje jashtë vendit me kartë debiti “CREDINS Bank” – E. M.	148 289	0
	Shpenzime për blerje me kartë debiti “RAIFFEISEN Bank” – E. M.	0	122 400
	REZULTATI FINANCIAR = Të ardhura - (Pasuri -Detyrime) - Shpenzime	-37 012	-1 414 722

*Analiza e kësaj periudhe është kryer bazuar në deklaratimet e subjektit në DPV-në e vitit 2017 dhe të dhënat bankare mbi të ardhurat dhe likuiditetet në vitet 2017 dhe 2018.

132. Nga analiza financiare e viteve 2017 – 2018, duket se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar shpenzimet si dhe shtesën në kursime për vitin 2017 dhe 2018 ku rezulton një diferencë negative prej -37.012 lekë për vitin 2017 dhe një diferencë negative prej -1.414.722 lekë për vitin 2018, të pajustificuara me burime të ligjshme, në total rezultati negativ për periudhën 2017 – 2018, **është në vlerën 1.451.734 lekë.**

133. Subjekti nuk ka pasur burime të mjaftueshme financiare të ligjshme për të justifikuar derdhjen e shumës prej 1.410.000 lekësh në llogarinë e tij bankare në datën 18.6.2018.

134. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën lidhur me rezultatin financiar të viteve 2017 – 2018, si dhe të shpjegojë bindshëm burimin e të ardhurave të shumës prej 1.410.000 lekësh, derdhur në bankë, e cila ka shërbyer më tej për pagimin e vitit të parë të studimeve për djalin e tij.

135. Subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet e tij lidhur me barrën e provës, sipas pikës 120 dhe pikës 134, të këtij vendimi, duke sqaruar sa vijon:

- *Nuk kam deklaruar llogaritë bankare të familjarëve, pasi në këto llogari nuk kanë pasur të ardhura të depozituara veçmas apo gjendje cash në llogaritë rrjedhëse, ashtu siç ka rezultuar, por në fund të çdo viti, para deklaratimit unë kam pyetur familjarët e mi nëse kanë depozitë në banka apo gjendje cash në llogaritë rrjedhëse, në mënyrë që ato t'i deklarojmë.*

- *Lidhur me kartat Credins Bank, përdorur nga vajza E. M., në vitet 2014 – 2017, pas konstatimit tuaj për vlerën reale të blerjeve kam rënë në dijeni të faktit se, me këto karta janë bërë blerje online nga vajza E., dhe shoqet e saj për veshje, këpucë, çanta etj. Në analizën financiare shpenzimet e kryera nga vajza E., për blerjet online në pjesën takuese të saj janë shpenzime për jetesë familjare dhe nuk duhet të pasqyrohen si shpenzime më vete, ashtu siç janë pasqyruar. Po kështu, dhe blerjet me kartën Raiffeisen Bank që janë bërë në vitin 2018 janë shpenzime të bëra për veshje të familjes time, prandaj ato janë shpenzime të kryera për jetesë.*

- *Nga verifikimet e kryera pas konstatimit tuaj ka rezultuar që në llogaritë bankare për blerje online nëpërmes vajzës E. M., kanë bërë blerje dhe shoqet e saj, shtetaset Xh. D., O. I., E. I., dhe I. M., të cilat i kanë dhënë lekë në mirëbesim E., në periudha të ndryshme, gjatë këtyre katër viteve. Ajo i ka derdhur në bankë dhe më pas kanë bërë blerjet online, vajza ime dhe shoqet e saj, nëpërmjet kartës së vajzës time, E., ku gjithësecila prej tyre e ka pasur numrin e kartës dhe kodin për përdorimin e saj. Këto veprime i kanë bërë sepse një pjesë e mirë e blerjeve janë kryer në dy faqet online *** dhe ***, ku E., ka pasur llogarinë e saj dhe ka përfituar ulje të ndryshme për shkak se ka qenë kliente e rregullt. Këto faqe online ofrojnë oferta dhe ulje në çmim, në qoftë se klientët e tyre bëjnë sa më shumë blerje, kështu që shoqet e E., dhe E., kanë vendosur të përdorin llogarinë e saj që të përfitojnë të gjitha së bashku nga ofertat dhe uljet në çmim të produkteve që kanë blerë.*

- *Sipas deklaratimeve të tyre, shtetësja Xh. D., për katër vite ka shpenzuar 240.000 lekë, ndërsa të tjerat kanë shpenzuar pjesën e mbetur në mënyrë të barabartë, afërsisht nga 119,460 lekë për katër vitet secila. Pra vajza E., ka shpenzuar 119.460 për blerjet online, dhe kjo është e paqyruar në shpenzimet jetësore të familjes. Një pjesë të blerjeve në vitet 2014 e 2015 vajza E., i ka bërë me lekët e dërguara, nga shoqja E. L., në qershor 2014. Shih shkresën nr. ***, datë 24.5.2009 të Unioni Financiar Tiranë.*

- *Ky fakt provohet me deklaraten noteriale nr. *** kol., nr. *** rep., datë 28.5.2019, në të cilën vërtetohet se gjatë viteve 2014, 2015, 2016, 2017 shtetaset Xh. D., O. I., E. I., dhe I. M., kanë derdhur lekë në llogarinë credins. Bashkëlidhur keni deklaratën noteriale nr. *** kol., nr. *** rep., datë 28.5.2019.*

- *Kërkoj të thirren e të pyeten për këtë fakt me cilësinë e dëshmitareve shtetaset: (1) E. I. M., (2) Xh. B. D., (3) O. H. I., (4) E. M. I., (5) I. L. M.*

136. Trupi gjykues administroi të gjitha deklaratat noteriale të paraqitura nga subjekti dhe çmoi si të panevojshme dëshmitë, për sa kohë që ekzitojnë deklaratat noteriale të paraqitura nga subjekti dhe të pranuar nga Komisioni.

137. Lidhur me shpenzimet e përfshira në analizën financiare për udhëtimet e subjektit të rivlerësimit dhe personat e lidhur, subjekti ka sqaruar se:

- *Ashtu siç kam dhënë shpjegime, udhëtimet e vajzës E. M., jashtë territorit shqiptar për periudhën 2009 – 2014 janë përballuar nga bashkëjetuesi i saj E. G. Ndërkohë, ai ka përballuar dhe shpenzimet e udhëtimit për djalin E., nga 29.6.2014 deri më 10.7.2014, dhe për vajzën E., nga 17.10.2014 deri më 19.10.2014, si dhe shpenzimin e udhëtimit të bashkëshortes time Sh. M., nga 7.3.2014 deri më 9.3.2014, kjo si dhuratë me rastin e 8 Marsit. Po kështu, në vitin 2009 i ka dhënë vajzës E., 1,000 euro. Kjo provohet me deklaratat noteriale datë 4.6.2019, lëshuar nga E. G., dhe datë 24.5.2019, lëshuar nga E. M., si dhe vërtetimi nr.***, datë 25.3.2019 dhe kontratat depozitë me afat, datë 2.9.2013.*

- *Për sa i përket llogaritjes së udhëtimeve të pjesëtarëve të familjes nga Tirana në Tropojë dhe anasjelltas, rezultun se ka pasaktësi, pasi sipas përlllogarijeve tuaja linja Tiranë - B.Curri - Tiranë kushton 50 euro (9.5 litra karburant në 100 km, ku linja Tiranë - B.Curri - Tiranë është 500 km). Mirëpo, ka rezultuar nga pasqyra që janë llogaritur 50 euro në disa raste linja Tiranë - B.Curri ose B.Curri Tiranë, kur duhej llogaritur me 25 euro, gjithnjë sipas përlllogaritjes tuaj.*

*Nga ana e juaj është llogaritur se autovetura harxhon 9.5 litra në 100 km. Mirëpo, autoveturat që ne kemi pasur në përdorim, “Benzi ***”, vit prodhimi 2003 dhe “Ford Fiesta”, vit prodhimi 2006 përdorur nga vajza E., deri në vitin 2014, nuk harxhojnë 9.5 litra në 100 km, por harxhojnë më pak. Konkretisht, sipas një klikimi në faqet e kompanive të Benzit e Fordit rezultun se:*

a) *“Benzi ***” vit prodhimi 2003 automatik gjatë lëvizjes harxhon; në qytet 8.7 litra/100km, në rrugë të largëta 4.6 litra/100 km, mesatare e kombinuar 6.3 litra/100 km. Mesatarisht për rrugën Tiranë - B.Curri - Tiranë harxhon 6.3 litra/100km, prandaj dhe llogaritja duhet bërë 6.3 litra /100 km, ku çmimi i naftës duhet llogaritur me 1.1 euro litri, afërsisht 34 euro për 500 km, pasi në të gjitha udhëtimet që kam kryer në linjën Tiranë - B.Curri - Tiranë, nëpërmes Kosovës, naftën e kam blerë në Kosovë, sepse çmimi ka qenë gjithnjë më i ulët se çmimi në teritorin shqiptar (afërsisht 1 euro), po kështu në 70% të rrugës shpenzimi në karburant është më i ulët se mesatarja, për shkak se është autostradë.*

b) *Fordi Fiesta, vit prodhimi 2006 manual, gjatë lëvizjes harxhon; në qytet 5.8 litra/100km, në rrugë të largëta 3.8 litra/100 km, mesatare e kombinuar 4.5 litra/100 km. Mesatarisht për rrugën Tiranë - B.Curri - Tiranë harxhon 4.5 litra/100km, prandaj dhe llogaritja duhet bërë 4.5 litra/100 km.*

- *Në disa raste kur unë dhe familjarët e mi kemi udhëtuar me njerëzit tanë me mjetet e të afërmëve tanë, si vëllezërit e mi apo djemtë e tyre ne nuk kemi paguar, pasi dhe ato nuk kanë paguar kur kanë lëvizur me mjetet tona, kjo është pjesë e marrëdhënieve familjare të ndërsjellta.*

- *Po kështu, në disa raste kur vajza E. M., ka lëvizur me grup shoqesh e shokësh nuk ka paguar për furnizimin e mjetit me karburant, pasi kjo është përballuar nga drejtuesi mjetit. Në këto raste kërkoj të thirret me cilësinë e dëshmitares për të saktësuar çdo shpenzim që ajo ka bërë për lëvizjet jashtë shtetit.*

- *Për sa është konstatuar nga ana e juaj lidhur me mjetin tip “Ford”, i cili ka qenë në pronësi të vajzës E., ashtu siç kam deklaruar, të ardhurat e përfituara nga shitja e këtij mjeti kanë qenë 100 % në zotërim të vajzës. Me një pjesë nga këto të ardhura, vajza E., ka përballuar shpenzimet e udhëtimit me avion të bashkëshortes Sh., e djalit E., duke u prerë biletën e udhëtimit vajtje - kthim, përkatësisht, vajtje 11.8.2015 e kthim 25.7.2015, si dhe shpenzimin e udhëtimit*

të vajzës E., duke i prerë biletën vajtje - kthim, përkatësisht vajtje 14.9.2015 e kthim 20.9.2015. Në këto udhëtime bashkëshortja, djali e vajza nuk kanë pasur shpenzime për fjetje e ushqim, pasi ato kanë qëndruar tek vajza E. Me të drejtë nga ana e juaj, këto udhëtime nuk janë përfshirë në analizën financiare.

- Për sa i përket shpenzimeve jetike të përhira në analizën financiare nga ana e juaj, ku jeni referuar treguesve statistikorë të përlllogaritura nga INSTAT, nuk kam ndonjë kontestim, pasi ky është referim ligjor. Në lidhje me shpenzimet familjare të mia, vlen të theksoj se duhet të merren parasysh në analizën financiare dhe rrethanat si më poshtë:

a) Blerjet që ka bërë vajza E. M., për pjesën takuese të saj, ku ajo ka derdhur vetë lekët e familjes në vitet 2014, 2015, 2016, 2017, 2018 duhet të përfshihen në shpenzime për jetesë të familjes, pasi të tilla ato janë, sepse këto blerje janë bërë për pjesëtarët e familjes dhe këto shpenzime nuk janë shpenzime ekstra vetëm për vajzën E.

b) Gjatë punës si gjyqtar në Krimet e Rënda që nga 1.3.2004 e në vijim, për shkak të detyrës, shpenzimet për telefon e udhëtimi me mjet për në punë janë përballuar nga shteti, si trajtim preferencial, pra për këto nuk kam pasur shpenzime.

c) Shpenzimet për disa produkte ushqimore si djath, gjizë, salcë kosi, mish, fasule, miell misri, mjaltë kanë qenë më të pakta, pasi këto produkte në disa raste i kam marrë gratis në formë kleringu tek vëllai B. M., si kompensim për shfrytëzimin që ai i bën tokës që unë kam në pronësi në fshatin *** Tropojë për kullotën e bagëtive. Kërkoj të pyetet për këtë fakt me cilësinë e dëshmitarit B. Sh. M., fshati ***, Tropojë, cel nr.xxx.

d) Gjatë periudhës së verës fëmijët e mi kanë qëndruar në Tropojë, ku dhe shpenzimi ka qenë më modest, pasi ato janë ushqyer me pjesëtarët e familjes ku kanë qëndruar, qoftë tek dajat e tyre, ashtu dhe tek xhaja i tyre. Kërkoj të pyetet për këtë fakt me cilësinë e dëshmitarit B. Sh. M., fshati ***, Tropojë, cel nr.xxx.

- Duke llogaritur të ardhurat e krijuara nga qiraja e banesës, ndryshimet në shpenzimet për udhëtime, si dhe ato për blerjet online rezulton se nga të ardhurat e ligjshme kursimet familjare cash në banesë, deklaruar në deklaraten "Vetting" kanë qenë 1.500.000 lekë.

138. Lidhur me analizën për shpenzimet në vitet 2017 – 2018 subjekti ka shpjeguar sa vijon:

- Për sa i përket shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit, ashtu siç kam shpjeguar hollësisht në shpjegimet me shkrim, ato janë më të pakta nga ato që keni llogaritur ju.

- Lidhur me derdhjen cash të shumës 1.410.000 lekë më datë 18.6.2018, rezulton se kjo sasi lekësh është e ardhur e ligjshme që rrjedh nga kursimet e mia familjare në vitet: 2012 – 800.000 lekë, 2013 – 300.000 lekë, 2014 – 650.000 lekë dhe 2015 – 50.000 lekë, ku në total është 1.500.000 lekë cash gjendje ne banesë, shumë kjo e deklaruar dhe në deklaraten "Vetting".

- Lidhur me konkluzionin e arritur nga ana e juaj në analizën financiare të vitit 2017 dhe 2018 ku thuhet se subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar shpenzimet, kjo nuk qëndron, pasi duke llogaritur të ardhurat e krijuara nga qiraja e banesës, si dhe ndryshimet në shpenzimet për udhëtim dhe ato për blerjet online, rezulton se nga të ardhurat e ligjshme është arritur të justifikohen të gjitha shpenzimet e kryera nga unë dhe familja ime, gjatë periudhës 2003 – 2018.

139. Në vlerësim të shpjegimeve të subjektit lidhur me analizën financiare të Komisionit dhe shpenzimet e përlllogaritura, trupi gjykues i kërkoi zyrës së shërbimit ligjor të përgatisë analizën financiare për subjektin e rivlerësimit duke marrë në konsideratë shpjegimet e tij lidhur me:

- blerjet online vetëm për pjesën e vajzës së subjektit, për periudhën 2014 – 2017, në shumën totale prej 118.803 lekësh.

- blerjet e kryera nga karta e debitit pranë "Raiffeisen Bank" në emër të E. M., në vitin 2018, shuma prej 122.400 lekësh.

140. Sipas anketës së buxhetit të familjes përgatitur nga INSTAT, në strukturën e shpenzimeve, grupi i konsumit veshmbathje është mesatarisht 5 % e shpenzimeve totale vjetore. Tabela shpjeguese më poshtë:

	2014	2015	2016	2017	2018
Shpenzime blerje <i>online</i> E.M.	29 701	29 701	29 701	29 701	122 400
Shpenzime për veshmbathje sipas INSTAT (5% e shpenzimeve vjetore)	55 000	44 855	47 018	47 018	44 080

141. Trupi gjykues pranoi shpjegimet e subjektit duke mos i përfshirë këto shpenzime pasi ato janë të përfshira në anketën e buxhetit të familjes, me përjashtim të shpenzimeve për vitin 2018, të cilat rezultuan më të larta duke përfshirë në shpenzime diferencën.

142. Në lidhje me shpenzimet e udhëtimeve sipas sistemit TIMS janë përlogaritur shpenzime për udhëtimet e subjektit dhe familjarëve të tij drejt Tropojës, në total 123 udhëtime, duke përdorur vlerën prej 34 eurosh udhëtim vajtje - ardhje për automjetin tip “Benz ***” dhe 24 euro udhëtim vajtje - ardhje për automjetin tip “Ford Fiesta”, sipas përlogaritjes së subjektit, duke pranuar shpjegimet e dhëna prej tij (kjo vlerë është përdorur edhe në rastet kur nga sistemi TIMS është regjistruar vetëm hyrja dhe jo dalja, apo e kundërta). Nuk janë përlogaritur shpenzime udhëtimi drejt Tropojës për rastet kur subjekti deklaroi se ai dhe familjarët e tij kanë udhëtuar si pasagjerë në automjetet e personave të tretë, sipas deklarimit të subjektit, të cilat u verifikuan nëpërmjetë sistemit TIMS edhe nga Komisioni.

Janë përlogaritur shpenzime udhëtimi jashtë vendit (në total 48 udhëtime jashtë vendit) për të gjitha rastet kur subjekti nuk ka provuar me dokumentacion ligjor burimin e të ardhurave të personave të tretë të deklaruar si financues të udhëtimeve nga subjekti, ndërsa nuk janë përlogaritur shpenzime udhëtimi për ato udhëtime për të cilat subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor justifikues.

Tabelë krahasuese pretendime subjekti/ vlerësimi i Komisionit	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	TOTALI
Udhëtime jashtë vendit në Euro sipas subjektit	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €	870 €	- €	870 €
Udhëtime jashtë vendit në Euro sipas Komisionit	350 €	1 670 €	3 230 €	2 897 €	5 540 €	600 €	- €	870 €	- €	15 157 €
Udhëtime në Tropojë në Euro sipas subjektit	291 €	264 €	288 €	403 €	330 €	476 €	390 €	288 €	458 €	3 188 €
Udhëtime në Tropojë në Euro sipas Komisionit	291 €	264 €	288 €	403 €	330 €	476 €	390 €	288 €	458 €	3 188 €

143. Në baze të analizës financiare të rishikuar, përgatitur nga njësia e shërbimit ligjor, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka një gjendje financiare negative për vitet 2006, 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013 dhe 2014 në vlerën totale prej - 3.131.085 lekësh, e pajustificuar me burime të ligjshme.

Subjekti IDRIZ MULKURTI	Para 2003	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	TOTAL
PASURI	7 255	0	0	633 290	5 716 212	568 516	505 178	415 496	1 431 530	212 014	554 448	297 468	1 242 911	-299 505	200 295	11 477 854
Apartament 59 m2 ne B. Curri deklaruar 0 lek ne DVP dhe Vetting	7 255															0
Apartament 84 m2, rr."****", Tirane, blere ne 2006 (92 m2 me amb. perbashketa)					6 259 372											6 259 372
Automjet "Benz C200", targa ***, blere ne 18.01.2010									1 073 104							1 073 104
Garazh 22.2 m2, rr."****", Tirane, blere ne 2010									1 943 340							1 943 340
Automjet "Ford Fiesta", targa ***, dhurate vajzes E. nga I fejuari E.G.										249 136			-249 136			0
Diference LIKUIDITETI (Lik. Aktual - Lik. Viti paraardhes)	0	0	0	633 290	-543 160	568 516	505 178	415 496	-1 584 914	-37 122	554 448	297 468	1 492 047	-299 505	200 295	2 202 038
LIKUIDITETE (FUND VITI Dokumentuar)	0	0	0	633 290	90 131	658 647	1 163 825	1 579 321	-5 593	-42 715	511 733	809 201	2 301 248	2 001 743	2 202 038	
DETYRIME	0	0	0	0	5 000 000	-291 808	-300 684	-309 829	80 747	-728 963	-338 969	-349 279	-359 903	-370 849	-800 963	1 229 501
Kredi per strehim, per blerjen e ap. ne Tirane nga Raiffeisen Bank	0	0	0	0	5 000 000	-291 808	-300 684	-309 829	-319 253	-328 963	-338 969	-349 279	-359 903	-370 849	-800 963	1 229 501
Detymim ndaj ****shpk" diferencen prej 3.200 euro per garazhin e blere ne vitin 2010									400 000	-400 000						
PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)	7 255	0	0	633 290	716 212	860 324	805 861	725 325	1 350 783	940 978	893 417	646 747	1 602 814	71 344	1 001 258	10 248 353
TE ARDHURA	0	953 223	1 460 612	1 210 248	1 254 079	1 426 087	1 517 415	1 514 398	1 816 983	2 533 011	2 239 435	2 110 546	4 302 762	2 096 120	2 539 522	26 382 917
Te ardhura te dokumentuara SR		781 188	1 287 695	1 127 943	1 083 595	1 186 082	1 189 960	1 168 872	1 435 654	1 314 133	1 352 180	1 361 017	1 563 222	1 642 737	1 697 333	18 191 611
Te ardhura te dokumentuara bashkeshortja SR		172 035	172 917	82 305	170 484	240 005	327 455	345 526	381 329	411 294	430 286	459 639	493 044	453 383	452 148	4 591 850
Te ardhura nga punesimi E.M. (Vajza SR)	0	0	0	0	0	0	0	0	0	558 448	456 969	289 890	454 972	0	0	1 760 279
Te ardhura nga punesimi E.M. (Vajza SR)		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	345 041	345 041
Shperblim Bashkia Tirane si student ekselence E.M. (Djali SR)															45 000	45 000
Te ardhura CASH nga qiraja e apartamentit ne Lagjen *****, B.Curri - e parapaguar per te githe periudhen									0							0
Te ardhura nga dhurimi I automjetit "Ford Fiesta" vajzes SR nga I fejuari E. G.										249 136						249 136
Te ardhura nga dasma e vajzes E.M. me 27.12.2014 (260 te ftuar)													1 200 000			1 200 000
Te ardhura nga shitja e automjetit "Ford Fiesta" te vajzes E.M.													591 524			
	Nr. Persona	5	5	5	5	5	5	5	5	5	5	5	5	4	4	
SHPENZIME	0	469 820	955 820	547 785	547 785	845 309	836 234	815 988	1 181 754	2 039 751	1 750 873	1 721 824	3 563 822	1 146 506	1 037 262	16 473 113
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI	0	469 820	469 820	547 785	547 785	683 100	683 100	683 100	683 100	683 100	697 740	705 120	1 099 990	897 104	940 368	9 321 212
Shpenzime per qira Tirane parapagim janar 2005-gusht 2006 sipas pyetesorit dt 27.03.2019 dhe dt. 01.05.2019			400 000													
Shpenzime interesi per shlyerjen e kredite tek Raiffeisen Bank						146 009	137 134	127 988	118 564	108 854	98 848	88 538	77 915	66 968	44 139	1 014 958
Shpenzim per pasaporten (sipas vartetimeve te pagave viti 2009)								4 900								4 900
Shpenzime udhetimi jashte vendit - TIMS								0	88 977	267 472	491 535	462 693	822 446	148 111	52 755	2 333 990
Shpenzime per dictat e marra (sipas vartetimeve te pagave)			86 000													86 000
Shpenzim per tatimin ne burim per qirane e ap. ne Tropoje											148 379					148 379
Shpenzime per takse shitje apartamenti dhe garazhi paguar per ZVRPP ne 28.06.2010									117 600							
Shpenzim per pagesen e faturave te OSHEE per ap. ne B.Curri sipas kont.s se qirase														34 322		34 322
Shpenzim per nderhyrje mjekesore E.M.													153 307			153 307
Shpenzime arsimimi ne London *** University, <u>E.M.</u>																0
Shpenzime per testin e gjuhes angleze E.M. dhjetor 2017																0
Shpenzime ne <u>Londër E.M.</u> (viza & siguracioni, per tre vite shkollore)																0
Shpenzime ne <u>Londër E.M.</u> (transport, veshmbathje, etj) shtator - dhjetor 2018																0
Shpenzime arsimi Bachelor dhe Master ne *** per vajzen, <u>E.M.</u>									173 513	380 325	314 370	315 473	210 165			1 393 845
Shpenzime arsimimi Universiteti *** Tirane, <u>E.M.</u>																0
Shpenzime arsimi Master per vajzen, <u>E.M., universiteti TIRANE</u>												150 000				150 000
Shpenzime arsimimi Bachelor E.M., <u>universiteti SHKODER</u>						16 200	16 000									32 200
Shpenzime mobilimi apartamenti sipas pyetesorit date 02.05.2019										600 000						600 000
Blerje jashte vendit me karte debiti CREDINS Bank - E.M.													0	0	0	0
Shpenzime per blerje me karte debiti RAIFFEISEN Bank - E.M.																0
Shpenzime per dasmen e vajzes E.M. me 27.12.2014													1 200 000			1 200 000
Rezultati financiar I dokumentuar (Te ardhura - Pasuri Neto - Shpenzime)		483 403	504 792	29 173	-9 918	-279 546	-124 680	-26 915	-715 554	-447 718	-404 854	-258 025	-863 874	878 270	501 002	
Kursime CASH te deklaruar nga subjekti ne DPV		-	-	500 000	500 000	500 000	500 000	500 000	-	-	500 000	300 000	650 000	50 000	-	
Aftesia reale per te kursyer me burime te ligjshme		0	0		490 082	220 454	375 320	473 085		0	95 146	41 975	0	50 000		

144. Nga analiza financiare duket se subjekti nuk ka pasur mundësi të kursejë nga të ardhurat e ligjshme shumë *cash* prej 1.500.000 lekësh të deklaruar në deklaratën “Vetting”, deri në datën 31.12.2016, por vetëm shumë 187.121 lekë.

145. Gjithashtu, në bazë të analizës financiare të rishikuar për periudhën 2017 – 2018, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka një gjendje financiare negative, të pajustificuar me burime të ligjshme për vitin 2018, në shumë -1.159.630, e cila paraqitet në tabelën si vijon:

Përshkrimi	2017	2018
PASURI	886 375	453 329
Ndryshimi i likuiditetit (Gjendje në fillim të vitit - gjendje në fund të vitit)	886 375	453 329
DETYRIME	-293 690	-277 798
Kredi për strehim, për blerjen e ap. në Tiranë nga “Raiffeisen Bank”	-293 690	-277 798
TË ARDHURA	2 564 610	2 616 303
Të ardhura nga paga e subjektit, të dokumentuara	1 590 134	1 510 672
Të ardhura nga bashkëshortja, të dokumentuara	427 919	465 626
Të ardhura nga punësimi E. M. (vajza e subjektit)	526 557	615 005
Shpërblim Bashkia Tiranë si student ekselece E. M. (djali i subjektit)	20 000	25 000
SHPENZIME	1 154 677	3 044 806
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	940 368	881 595
Shpenzime interesi për shlyerjen e kredisë të “Raiffeisen Bank”	32 869	23 825
Shpenzime udhëtimi jashtë vendit - sipas sistemit TMS	153 956	56 540
Shpenzime për testin e gjuhës angleze, E. M., dhjetor 2017	27 484	
Shpenzime arsimimi në London *** University, E. M.	0	1 575 905
Shpenzime në Londër, E. M. (viza & siguracioni, për tre vite shkollore)	0	136 258
Shpenzime në Londër E. M. (transport, veshmbathje, etj) shtator – dhjetor 2018		107 188
Shpenzime arsimimi Universiteti *** Tiranë, E. M.	0	185 175
Blerje jashtë vendit me kartë debiti CREDINS Bank – E. M.	0	0
Shpenzime për blerje me kartë debiti RAIFFEISEN Bank – E. M.	0	78 320
REZULTATI FINANCIAR = Të ardhura - (Pasuri - Detyrime) - Shpenzime	229 868	-1 159 630

146. Subjekti nuk justifikon me burime të ligjshme derdhjen në llogarinë e tij bankare në shumë 1.410.100 lekë në vitin 2018, shumë e cila është përdorur për pagesën e tarifës për vitin e parë të studimeve të të birit në London *** University (***) në Londër, po në të njëjtin vit.

Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të pasurisë

Nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit u evidentuan pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht. Nga hetimi rezultoi se bilanci financiar, sipas këshillimit të Njësisë së Shërbimit Ligjor, është negativ dhe subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të justifikojë me burime të ligjshme shpenzimet e kryera ndër vite.

Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të bindë trupin gjykues lidhur me ligjshmërinë e burimeve financiare të përdorura prej tij për: (i) pagesë të këstit të parë të blerjes së apartamentit në shumë 20.600 euro (ose 2.548.282 lekë) pasi ai mund të paguante vetëm shumë prej 979.858 lekë, (ii) për shumë prej 10.800 euro (ose 1.499.148 lekë) të përdorur për blerjen e garazhit dhe (iii) për pagesën e studimeve për të birin në Londër në shumë 11.222 paund (ose 1.575.905 lekë) kishte një mungesë në shumë prej 1,159,630 lekë.

B. VLERËSIMI I FIGURËS

147. Drejtorja e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, ajo ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit 84/2016, ku ka konstatuar “Përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit z. Idriz Mulkurti”. Ky raport është i deklasifikuar.

Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramentit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

Nga hetimi administrativ, nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Për subjektin e rivlerësimit konstatohet se është në kushtet e përshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës.

Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të figurës

Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar prej subjektit të rivlerësimit, deklaratën për kontrollin e figurës, raportin e DSIK-së, informacione nga organet ligjzbatuese, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramentit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk u provua që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, apo që ai të jetë i përfshirë, apo i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë e gjen atë të përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

148. Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional të subjekteve, dërgoi raportin profesional për subjektin e rivlerësimit, bazuar në tri dokumente ligjore, të llojit vendim gjyqësor të viteve 2014, 2015 dhe 2016, si dhe pesë dosje të përzgjedhura më short.

149. Në analizë të përbashkët të tri dokumenteve të përzgjedhura nga vetë subjekti, konstatohet se subjekti i rivlerësimit mban të njëjtin stil në hartimin e vendimeve dhe organizimi strukturor i vendimeve paraqitet në nivel mesatar.

150. Subjekti i rivlerësimit jo në çdo rast ka aftësi të mira në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se në përgjithësi ai identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në përgjithësi, vërehet se në arsyetimin ligjor të vendimeve, pjesën më të madhe e zënë pasqyrimi i provave, kryesisht deklaramentet dhe përgjimet e bisedave, duke mos u ndalur në identifikimin e kërtimeve të organit të prokurorisë dhe prapësimet e mbrojtjes për t'i analizuar ato në raport me provat e paraqitura, duke bërë që në dy raste konkludimi për faktin penal, si dhe masën e dënimit që duhet caktuar, të jetë cenuar nga gjykatat më të larta. Nga 3 vendimet e përzgjedhura nga vetë subjekti dhe 5 dosjet e përzgjedhura me short, del se subjekti përgjithësisht i njeh parimet e përgjithshme të së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe i zbaton ato në praktikë, por nuk i bën pjesë të vendimeve gjyqësore shprehimisht. Në çështjet e trajtuara nuk ka të dhëna për njohjen dhe zbatimin e të drejtës ndërkombëtare, zbatimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut apo vendimet e GJEDNJ-së.

151. Subjekti i rivlerësimit i harton vendimet përgjithësisht me strukturë të standardizuar. Vendimet përfundimtare të tij respektojnë kërkesat e ligjit procedural penal. Përmbajtja e vendimit përgjithësisht është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Jo në çdo rast analiza ligjore është e thelluar, duke paraqitur normën penale të zbatueshme dhe duke dhënë arsyet pse ajo zbatohet në rastin konkret. Në analizën ligjore mungojnë sipas rastit, referenca në normat ndërkombëtare, KEDNJ, por edhe referenca në Jurisprudencën e GJEDNJ-së. Në ndonjë rast ka referencë në Jurisprudencën e Gjykatës së Lartë (vendimet unifikuese), kryesisht për gjykimin e shkurtuar. Dispozitivi hartohet me tekst të qartë dhe të plotë, duke treguar sipas rastit të gjitha disponimet që shoqërojnë vendimin e fajësisë apo të pafajësisë, vendin e vuajtjes së dënimit, disponimi për provat materiale, e deri tek e drejta e ankimit për palët, por pa u shprehur në lidhje me afatin e ushtrimit të kësaj të drejte. Niveli i arsyetimit të vendimeve ligjore të vëzhguara, përgjithësisht respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

152. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtarin Idriz Mulkurti është paraqitur një ankesë në vitin 2014, e cila është arkivuar pas shqyrtimit fillestar si ankesë e trajtuar më parë.

153. Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Idriz Mulkurti përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

Konkluzione për rubrikën e vlerësimit profesional

Trupi gjykues vlerëson se, në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve dhe konsiderohet “i aftë”.

Trupi gjykues arrin në përfundimin se, subjekti i rivlerësimit e ka nivelin minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

DENONCIMET E PUBLIKUT

1. Denoncim i shtetasit A. H., me nr. * prot., datë 6.11.2018** ndaj gjashtë subjekteve. Në këtë denoncim përfshihet edhe subjekti i rivlerësimit, i cili është denoncuar për vendim të padrejtë të marrë në trupë, caktuar me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. ***, datë 24.3.2017 pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, për shqyrtimin e çështjes penale nr. *** akti, me kërkues Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Përmet, me të pandehur K. S., akuzuar për veprën penale “Falsifikim i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal. Nga faktet e trajtuara në këtë denoncim, nuk ka indice për nisjen e hetimit ndaj subjektit të rivlerësimit.

2. Shtetasit R., dhe S. P., me nr. *, datë 15.3.2019** ndaj një trupi gjykues, pjesë e të cilit është edhe subjekti i rivlerësimit. Denoncimi ka në objekt zhvillimin e procesit të parregullt gjyqësor lidhur me çështje pronësie. Komisioni vlerësoi faktet e trajtuara nga denoncuesit, të cilat janë administruar në procese gjyqësore të filluara nga viti 1997 deri në vitin 2017, kur trupi gjykues ka vendosur, me vendimin nr. ***, datë 12.2.2017, “Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 19.2.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë”. Nga faktet e trajtuara në këtë denoncim, nuk ka indice për nisjen e hetimit ndaj subjektit të rivlerësimit.

Trupi gjykues, pasi vlerësoi denoncimet e ardhura në Komision, në mbështetje të nenit 53, të ligjit nr.84/2016, nuk gjeti indice apo fakte të cilat të ngrenë dyshime të arsyeshme mbi veprime korruptive të kryera nga subjekti i rivlerësimit apo në bashkëpunim me persona të tjerë.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenet 4 pika 2, 58, pika 1, germa “c”, si dhe 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti nuk ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Idriz Mulkurti.
2. Ky vendim i arsyetuar u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit, Komisionerit Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më 14.6.2019

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

KRYESUES

Lulzim Hamitaj

nënshkrimi

ANËTAR

Genta Tafa (Bungo)

nënshkrimi

RELATOR

Valbona Sanxhaktari

nënshkrimi

Sekretare gjyqësore

Fiorela Mandro

nënshkrimi